



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2020

PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 09.07.2020)

Pika 1 e rendit të ditës me objekt: Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor të datave: 15.05.2020, 18.05.2020, 28.05.2020, 04.06.2020 dhe 11.06.2020.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:00 dhe mbaroi në orën 13:30.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Maksim Qoku*** (zëvendëskryetar)
3. ***Medi Bici*** (anëtar)
4. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
5. ***Brunilda Kadi*** (anëtare)
6. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
7. ***Illir Toska*** (anëtar)
8. ***Alban Toro*** (anëtar)
9. ***Brikena Ukperaj*** (anëtar)
10. ***Erjon Muharremaj*** (anëtar)
11. ***Marçela Shehu*** (anëtare)

Merrnin pjesë gjithashtu:

1. *Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
2. *Elis Kuçi, Specialist pranë Drejtorisë së Marrëdhënieve me Publikun, me Jashtë dhe Botimet.*
3. *Pjesë nga stafi administrativ i KLGJ-së (nëpërmjet platformës).*
4. *Entela Dobi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë (nëpërmjet platformës).*
5. *Përfaqësues të misioneve EURALIUS dhe USAID (nëpërmjet platformës).*

RENDI I DITËS:

1. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor të datave: 15.05.2020, 18.05.2020, 28.05.2020, 04.06.2020 dhe 11.06.2020.

Naureda Llagami: Duke qenë se të gjithë anëtarët janë të pranishëm, po fillojmë mbledhjen e radhës së Këshillit të Lartë Gjyqësor të datës 9 korrik 2020.

Siç jeni në dijeni, në rend të ditës kemi parashikuar 12 pika, për të cilat kërkohet vendimmarrje nga ana e Këshillit. Nga ana tjetër, kemi një kërkesë nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, i cili kërkon të shtojë në rendin e ditës edhe 1 pikë tjetër me dy çështje që kanë të bëjnë me caktimin e gjyqtarëve në Gjykatën e Posaçme për Korrupsionin dhe në Gjykatën Administrative të Apelit.

Jemi dakord?

(Anëtarët e Këshillit janë dakord.)

Kalojmë tek çështja e parë e rendit të ditës, e cila ka të bëjë me miratimin e procesverbaleve të mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor të datave 15.05.2020, 18.05.2020, 28.05.2020, 04.06.2020 dhe 11.06.2020.

Procesverbalet ju janë përcjellë nga stafi administrativ. Janë reflektuar edhe sugjerimet që keni pasur.

Keni ndonjë koment?

Kalojmë në votimin e këtyre procesverbaleve?

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Dakord.

Dritan Hallunaj: Dakord, me përjashtimin tek ndonjë nga këto që nuk kam marrë pjesë. Dakord në përgjithësi.

Illir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi: 1. Miratimin e procesverbaleve të mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor të datave 15.05.2020, 18.05.2020, 28.05.2020, 04.06.2020 dhe 11.06.2020. 2. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi dhe publikimin e këtyre procesverbaleve Kryetarja e Këshillit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 1 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2020

PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 09.07.2020)

Pika 2 e rendit të ditës me objekt: Informim lidhur me Rezolutën e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, për Këshillin e Lartë Gjyqësor.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:00 dhe mbaroi në orën 13:30.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|-----------------------------|---------------------------------|
| 1. Naureda Llagami | <i>(kryetare)</i> |
| 2. Maksim Qoku | <i>(zëvendëskryetar)</i> |
| 3. Medi Bici | <i>(anëtar)</i> |
| 4. Fatmira Luli | <i>(anëtare)</i> |
| 5. Brunilda Kadi | <i>(anëtare)</i> |
| 6. Dritan Hallunaj | <i>(anëtar)</i> |
| 7. Ilir Toska | <i>(anëtar)</i> |
| 8. Alban Toro | <i>(anëtar)</i> |
| 9. Brikena Ukperaj | <i>(anëtar)</i> |
| 10. Erjon Muharremaj | <i>(anëtar)</i> |
| 11. Marçela Shehu | <i>(anëtare)</i> |

Merrnin pjesë gjithashtu:

***Mbledhje e Këshillit të Lartë Gjyqësor
Tiranë, më 09.07.2020 (Pika 2)***

- 1. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
- 2. Elis Kuçi, Specialist pranë Drejtorisë së Marrëdhënieve me Publikun, me Jashtë dhe Botimet.*
- 3. Pjesë nga stafi administrativ i KLGJ-së (nëpërmjet platformës).*
- 4. Entela Dobi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë (nëpërmjet platformës).*
- 5. Përfaqësues të misioneve EURALIUS dhe USAID (nëpërmjet platformës).*

RENDI I DITËS:

2. Informim lidhur me Rezolutën e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, për Këshillin e Lartë Gjyqësor.

Naureda Llagami: Çështja tjetër ka të bëjë me informimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor lidhur me Rezolutën e Kuvendit.

Siç jeni në dijeni me 25 qershor, në cilësinë e Kryetares, kam prezantuar në Kuvendin e Shqipërisë Raportin Vjetor të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe na është përcjellë nga Kuvendi i Shqipërisë, me datë 1 korrik 2020 Rezoluta e miratuar për Këshillin e Lartë Gjyqësor, Rezolutë të cilën unë në fakt jua kam bërë me dije, të gjithë anëtarëve të Këshillit, por do doja që të ndalesha në angazhimet që Kuvendi kërkon nga ana e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Kështu konkretisht ajo që Kuvendi nxit Këshillit të Lartë Gjyqësor është: 1. Të veprojë me ritme të shpejta për adresimin e zgjidhjeve të problematikave në sistemin gjyqësor; 2. T'i kushtojë rëndësi informimit të publikut për qasjen në drejtësi dhe mbarëvajtjes së marrëdhënieve të gjyqësorit me publikun; 3. Të forcojë bashkëpunimin me organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë dhe institucionet e tjera shtetërore në përputhje me parashikimet ligjore në fuqi për të gjitha proceset që ndikojnë në zbatimin e duhur dhe efektiv të reformës në drejtësi; 4. Të informojë vazhdimisht Kuvendin e Shqipërisë për problematikat e hasura në sistemin gjyqësor duke rekomanduar edhe zgjidhjet përkatëse.

Gjithashtu, Kuvendi i Shqipërisë, për vitin 2020, i kërkon Këshillit të Lartë Gjyqësor: 1. Shpalljen menjëherë të të gjitha vendeve të lira në Gjykatën e Lartë dhe përmbylljen në një kohë sa më të shpejtë të procesit të plotësimit të këtyre vendeve, sipas përcaktimeve të nenit 48 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe Prokurorëve

në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me qëllim vënien e kësaj gjykate në funksionalitet të plotë, realizimin e kuorumeve për shqyrtimet gjyqësore, sidomos ato të njësimin të praktikave gjyqësore nga Kolegjet e Bashkuara, si dhe përmbushjen e detyrave të Gjykatës së Lartë për zgjedhjen e tre anëtarëve për në Gjykatë Kushtetuese.; 2. Përfundimin e procedurave për plotësimin e vendeve të lira në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsion dhe Krimin e Organizuar dhe në Gjykatën e Shkallës së Parë për Korrupsion dhe Krimin e Organizuar; 3. Përmbylljen sa më parë të punës për hartën e re gjyqësore dhe formalizimin e propozimit të përbashkët me Ministrinë e Drejtësisë për riorganizimin e rretheve gjyqësore dhe kompetencat tokësore të gjykatave; 4. Përmbylljen e paketës së plotë me akte nënligjore normative dhe rregullatore, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të ndryshuar dhe ligjeve të tjera, që parashikojnë detyrimet për nxjerrjen e akteve nënligjore nga ana e Këshillit, veçanërisht aktet që normojnë rregullat e brendshme të funksionimit të Këshillit; 5. Zbatimin e një strategjie efektive për uljen e numrit të çështjeve civile, administrative dhe penale të mbartura, bazuar në analizën e kryer nga Këshilli pasqyruar në raportin vjetor 2019; 6. Bashkëpunimi me Shkollën e Magjistraturës për verifikimin me prioritet të kandidaturave të cilat mund të pranohen në formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës, për vitin 2020-2021; 7. Vijimin me ritme të shpejta të punës në hartimin dhe dorëzimin e raporteve të aftësive profesionale të gjyqtarëve pranë organeve të rivlerësimit kalimtar; 8. Fillimin dhe përfundimin sa më parë të procesit të vlerësimit etiko-profesional të gjyqtarëve, në përputhje me skemën e re të vlerësimit; 9. Forcimin e marrëdhënieve institucionale me ILD-në, me qëllim trajtimin në afate të arsyeshme të procedimeve disiplinore për magjistratët; 10. Vijimin e dhënies së opinioneve dhe vlerësimeve për përmirësimet ligjore në përputhje me përcaktimet e nenit 93 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të ndryshuar.

Këto ishin angazhimet që na kërkohen nga ana e Kuvendit.

Nëse keni ndonjë diskutim, unë jam e hapur që të diskutojmë të gjithë së bashku lidhur me përmbajtjen e këtyre angazhimeve dhe se si do veprohet nga ana e Këshillit për adresimin e tyre.

Po, zoti Toska!

Ilir Toska: Unë jam njohur me Rezolutën e Kuvendit të Shqipërisë dhe me të gjitha veprimtaritë për të cilat Kuvendi i Shqipërisë nxit Këshillin e Lartë Gjyqësor që të veprojë sa më shpejt. Jam shumë dakord me rekomandimet që ai bën. Nuk e them për justifikim, por Këshilli mund të kishte ecur edhe me ritme më të shpejta për disa aspekte. Gjithsesi, situata që ne ndodhemi është shumë e vështirë dhe komplekse. Jo të gjitha gjërat në fakt varen vetëm nga Këshilli i Lartë Gjyqësor.

Sa i përket përgjegjësive që ka Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, ne jemi përpjekur që të mbyllim të gjithë kuadrin nënligjor, për të mundësuar ecjen me shpejtësi të procedurave të ngritjes në detyrë, në veçanti për Gjykatën e Lartë dhe për Gjykatat e Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

Kemi qenë të hapur, kemi bashkëvepruar me të gjithë anëtarët e Këshillit që të mundësojmë që këto procedura të ecin dhe të kryhen në mënyrën më të mirë të mundshme. Do të isha dakord që të vijojë ky diskutim dhe bashkëveprim përfshirë dhe Misionet që na mbështesin, që aktivitetet tona t'i bëjmë në mënyrën më të mirë të mundshme, që mbarëvajtja e sistemit të jetë optimale, që Shqipëria të përmbushë kushtet për hapjen e negociatave me Bashkimin Evropian, por çdo aktor do duhet të konsiderojë edhe ato shqetësime dhe problematika që ne ngremë në vijim të veprimtarisë sonë të përditshme, për të cilat do të kishim nevojë për të adresuar disa problematika që ne ndeshim.

Nga ana tjetër, meqenëse në publik kam dëgjuar që ka pasur komente që Komisioni i Zhvillimit të Karrierës ka qenë bllokues për aktivitete të Këshillit, unë si Kryetar i këtij Komisioni nuk mund t'i pranoj këto akuza. Komisioni ka qenë gjithë kohës i angazhuar për të vijuar dhe për të shtyrë procedurat përpara. Asnjë nga anëtarët e Këshillit nuk ka pasur pengesë që të nxisë apo të kërkojë mbledhje plenare të vijojë procedura të caktuara. Pra jo vetëm faktikisht kjo gjë nuk ka ndodhur, por as ligjërisht kjo gjë nuk mund të ndodhte. Çdo anëtar e ka pasur të gjithë mundësinë ligjore që të adresojë çdo çështje që ka pasur shqetësim, ta bëjë pjesë të mbledhjes plenare, përfshi edhe propozime konkrete për zgjidhje të saj. Unë di që Komisioni ka vepruar në përputhje me të gjithë të menduarit dhe të vepruarit e Këshillit në tërësi si organ kolegjal. Kjo është e vetmja gjë që unë doja të theksoja. Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit, zoti Toska!

Ndonjë koleg tjetër?

Alban Toro: A mund të flas?

Naureda Llagami: Alban, kërkon fjalën?

Po!

Alban Toro: Nuk e di pse vjen zëri me shkëputje, por nëse nuk dëgjothem, më thoni.

Parimi i ndarjes së pushteteve më detyron që në këtë rast të riflas dhe të ritheksoj atë që dhe kam folur seancën e kaluar. Është një nga parimet më të rëndësishme të Kushtetutës të përcaktuar në nenin 7 dhe synon mbi të gjitha të mënjanojë rrezikun e përqendrimit të pushtetit të një organi apo personave të caktuar, e cila në vetvete sjell edhe rrezikun, shpërdorimin e pushtetit. Për këtë qëllim, pavarësisht se pushteti shtetëror është një dhe i pandarë, brenda tij ka një sërë ndërthurjesh dhe raportesh të ndërsjella që Kushtetuta krijon nëpërmjet segmenteve të caktuara të tij. Pra në thelb, në bazë të këtij parimi, tri pushtetet qendrore duhet të ushtrohen jo vetëm në mënyrë të pavarur por edhe në mënyrë të balancuar. Kjo gjë arrihet nëpërmjet zgjidhjeve kushtetuese që kanë të bëjnë kontroll të ndërsjellë dhe ekuilibër të mjaftueshëm midis pushteteve, pa cenuar dhe pa ndërhyrë në kompetencat e njëri-tjetrit. Në këtë kontekst, Gjykata Kushtetuese ka disa vendime, por më të spikatura janë vendimet nr. 24, 10.11.2006 dhe nr. 19, 03.05.2007.

Qëllimi i konceptit të tillë kushtetues siguron që të parandalojë çdo degë të qeverisjes për të ushtruar një pushtet të pakufizuar. Kontrolli dhe ekuilibrat që i njeh Kushtetuta, i japin secilës degë mbështetje që kompensojnë apo zbusin ato të degëve të tjera, dhe në këtë rast, Gjykata Kushtetuese ka elaboruar doktrinën (mjafton t'ju kujtoj vendimin nr. 11, 27.05.2004 të Gjykatës Kushtetuese). Ndonëse renditen njëri pas tjetrit, të tre pushtetet e përmendura nuk qëndrojnë në varësi hierarkike nga njëri-tjetri, por as nuk dominojnë apo i nënshtrohen ndikimeve reciproke ekstra-ligjore (mjafton t'ju kujtoj vendimin nr. 11, datë 06.04.2010 të Gjykatës Kushtetuese).

Gjykata Kushtetuese në jurisprudencën e saj është shprehur se parimi i shtetit të së drejtës detyron të gjithë organet e pushtetit publik që t'i ushtrojnë kompetencat e tyre vetëm në kuadër dhe në bazë të normave kushtetuese. Aktet juridike që nxirren nga këto

organe duhet të jenë në pajtim me aktet juridike me të larta, si në kuptimin formal, ashtu edhe atë material. Respektimi i hierarkisë së akteve normative është një detyrim që rrjedh nga parimi i shtetit të së drejtës dhe i koherencës në sistemin ligjor (shiko vendimin 2, 03.02.2010 të Gjykatës Kushtetuese i cili ka elaboruar këtë pjesë).

Kështu që, duke pasur parasysh është kuadër ligjor dhe këtë elaborim që ka bërë në mënyrë të veçantë Gjykata Kushtetuese parimit të ndarjes së tre pushteteve, kërkova të identifikojë bazën ligjore të rezolutës së Kuvendit, por nuk e gjeta. Në mungesë të saj hulumtova legjislacionin tonë, i cili përveç aspekteve të kontrollit të buxhetit, të emërimit të disa anëtarëve jogjyqtarë nga Kuvendi si anëtarë të KLGJ-së, nga pikëpamja e ndikimit e gjej vetëm në nenin 82 të ligjit nr. 115/2016 “Raportimi publik dhe para Kuvendit”, i cili ndër të tjera thotë: “4. Rekomandimet e përcjella në rezolutën e miratuar nga Kuvendi për raportin vjetor të Këshillit të Lartë Gjyqësor janë të detyrueshme për t’u marrë parasysh nga Këshilli për aq sa nuk cenojnë pavarësinë e këtij institucioni”. Në këtë kontekst kërkova të gjej kuptimin e rekomandimit. Na vjen në ndihmë “Enciklopedia e gjuhës shqipe”, botim i ’84-ës i Akademisë së Shkencave, të cilën e interpreton si këshillë, porosi ose mendim, që jepet për mënyrën si duhet vepruar a si të bëhet diçka.

Le t’i rikthehemi dispozitivit, nëse mund ta quaj kështu, të Kuvendit, të ashtuquajtur rekomandim të sjellë nga Kuvendi, i cili thotë: “Kuvendi i Shqipërisë, për vitin 2020 i kërkon Këshillit të Lartë Gjyqësor, shpalljen menjëherë të gjithë vendeve të lira...”, pra në gjuhën shqipe, forma quhet “formë urdhërore”, që do të thotë, kemi një urdhër që duhet të bëjmë disa gjëra. Në fakt, të gjitha këto që kërkon të bëhen, jo vetëm nga KZHK-ja por edhe nga KLGJ-ja, janë vlerësuar dhe janë synuar të realizohen, por gjithmonë duke analizuar edhe risqet apo skenarët më të këqij që mund t’i vijnë sistemit nga një veprim i pamatur. Natyrisht, në ndihmë na kanë ardhur edhe rekomandimet e partnerëve të huaj, të cilët shpeshherë na kanë asistuar në këto vendimmarrje. Më i fundit është rekomandimi që na ka sjellë USAID-i, në të cilën unë nuk gjej dot një formë urdhërore sepse synimi i rekomandimit është të këshillojë, të porosisë apo të japë mendim.

Kështu që në këtë kontekst, ndoshta do duhet t’i adresojmë një shkresë me informacione të detajuara Kuvendit të Shqipërisë, duke bashkëlidhur edhe rekomandimet që na kanë dhënë ata që në kanë asistuar, për mënyrën se si kemi proceduar deri tani në

hapjen e vendeve në Gjykatën e Lartë apo edhe më tej në të gjitha nivelet e gjykatave, si dhe skenarët e frikshëm që ne kemi mundur të evitojmë me hapjen e menjëhershme të vendeve të lira në Gjykatën e Lartë sepse ato mund të passjellin edhe mbylljen e një gjykate tjetër, të cilën askush nga ne nuk do ta dëshironte. Ju faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit, Alban!

Ndonjë koleg tjetër e do fjalën?

Atëherë, nëse nuk kemi ndonjë diskutim mbi atë çka Kuvendi na ka adresuar, unë do ftoja që secili nga Komisionet përkatëse, se këto janë angazhime për të gjithë ne, të reflektojmë dhe të mundohemi që t'i plotësojmë këto angazhime brenda kuadrin tonë ligjor. Nëse nuk kemi diskutim, vijojmë tek çështja tjetër e rendit të ditës?

(Anëtarët nuk kanë diskutime.)

* * *

(Pika 2 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2020

PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 09.07.2020)

Pika 3 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimeve lidhur me hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, nga radhët e gjyqtarëve, për pozicione të lira në fushën e të drejtës administrative/civile/penale, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës. (vijon shqyrtimi nga mbledhja e datës 2 korrik 2020 – për t’u vendosur me marrjen e opinionit ligjor nga Misioni Euralius V dhe Projekti “Justice for All” (USAID)).

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:00 dhe mbaroi në orën 13:30.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|---------------------------|--------------------------|
| 1. Naureda Llagami | (kryetare) |
| 2. Maksim Qoku | (zëvendëskryetar) |
| 3. Medi Bici | (anëtar) |
| 4. Fatmira Luli | (anëtare) |
| 5. Brunilda Kadi | (anëtare) |
| 6. Dritan Hallunaj | (anëtar) |
| 7. Ilir Toska | (anëtar) |
| 8. Alban Toro | (anëtar) |
| 9. Brikena Ukperaj | (anëtar) |

10. Erjon Muharremaj (anëtar)

11. Marçela Shehu (anëtare)

Merrnin pjesë gjithashtu:

- 1. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
- 2. Elis Kuçi, Specialist pranë Drejtorisë së Marrëdhënieve me Publikun, me Jashtë dhe Botimet.*
- 3. Pjesë nga stafi administrativ i KLGJ-së (nëpërmjet platformës).*
- 4. Entela Dobi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë (nëpërmjet platformës).*
- 5. Përfaqësues të misioneve EURALIUS dhe USAID (nëpërmjet platformës).*

RENDI I DITËS:

3. Shqyrtimi i projektvendimeve lidhur me hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, nga radhët e gjyqtarëve, për pozicione të lira në fushën e të drejtës administrative/civile/penale, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës. (vijon shqyrtimi nga mbledhja e datës 2 korrik 2020 – për t’u vendosur me marrjen e opinionit ligjor nga Misioni Euralius V dhe Projekti “Justice for All” (USAID)).

Naureda Llagami: Atëherë, çështja tjetër e rendit të ditës është shqyrtimi i projektvendimeve lidhur me hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, nga radhët e gjyqtarëve, për pozicione të lira në fushën e të drejtës administrative/civile/penale.

Nëse ju kujtohet edhe nga mbledhja e kaluar, shumica e Këshillit vendosi që përpara se të vlerësojë miratimin e këtyre projekt-akteve, t’i kërkonte një mendim, një opinion partnerëve tanë lidhur me mënyrën dhe sa e përshtatshme do ishte hapja e këtyre vendeve në Gjykatën e Lartë dhe sot në mëngjes, nëpërmjet e-mailit, na ka ardhur edhe mendimi i të dy partnerëve tanë. Unë do doja t’jua lexoja për efekt edhe të rekordeve në mbledhjen plenare. Kështu, pa dashur që të humbasim kohë, po lexoj vetëm pjesën e rekomandimeve për Këshillin e Lartë Gjyqësor, lidhur me çështjen që ne i parashtruam.

“KLGJ-ja luan një rol të rëndësishëm në garantimin e funksionalitetit të Gjykatës së Lartë. Ai është një organ kulmor, të cilit i është besuar funksionimi i mirë i pushtetit

gjyqësor në Shqipëri. Nga sa më sipër, hapat e renditura në vijim do të jenë të nevojshme që KLGJ-ja të garantojë funksionalitetin e Gjykatës së Lartë.

Pika e parë e cila ka të bëjë me caktim, ngritje në detyrë të gjyqtarëve në Gjykatën e Lartë: Me qëllim që të gjithë kolegjet e Gjykatës së Lartë të bëhen funksionale, siç përmendet edhe më lart, KLGJ-ja duhet të përfundojë shpejt procesin tashmë të filluar për emërimin e gjyqtarëve në Gjykatën e Lartë. Hapat e mëposhtme mund të merren në konsideratë me prioritet:

Së pari, përfundimin e procesit të emërimit të gjyqtarit të katërt, nga radhët e jomagjistratëve, me shpejtësi duke marrë hapa për t'i adresuar menjëherë të gjithë pengesat dhe projektet janë të gatshëm të vijnë në ndihmë për këtë çështje;

Së dyti, përcaktimi i një afati të arsyeshëm brenda të cilit do të përfundojnë procedurat e ngritjes në detyrë për gjashtë pozicionet tashmë të nisura, pozicionet në fushën e së drejtës civile dhe asaj administrative, dhe të publikohet afati i parashikuar;

Së treti, hapja pa vonesë e pozicioneve të nevojshme në fushën e së drejtës penale brenda afateve të shpejta por ama të arsyeshme kohore, që të lejohet sa më shpejt ngritja e kolegjeve të posaçme;

Së katërti, përcaktimi i fushave të së drejtës (penale, civile ose administrative) për pozicionet e mbetura dhe shpallja e tyre në mënyrë të tillë që KLGJ-ja të mund të kryejë me ritme të shpejta procesin e rekrutimit dhe të përzgjedhjes. Duhet të theksohen ato fusha të së drejtës që kanë përqindjen më të lartë të numrit të çështjeve të prapambetura në gjykatë. Aktualisht vlerësojmë se ky raport është 51% për çështjet civile, 32% për çështjet administrative dhe 17% për çështjet penale. Kryerja e një vlerësimi të shpejtë dhe të saktë rreth hapave të kërkuar për ngritjen në detyrë të një gjyqtari dhe koha mesatare shoqëruese për përfundimin e procesit dhe përcaktimi i ndikimeve në atë proces të vakancave të njëkohësishme dhe ato të njëpasnjëshme, Këshilli duhet të shohë ndikimet procedurale të të dyjave dhe më pas të procedojë në atë drejtim që i lejon përfundimin e sukseshëm dhe më të shpejtë të caktimit të ngritjes në detyrë.

Strukturat mbështetëse – Siç përcaktohet edhe më sipër, funksionaliteti i Gjykatës së Lartë nuk është thjesht çështje e numrit të gjyqtarëve të caktuar, por është çështje e organizimit të përgjithshëm dhe plotësisht me personel brenda gjykatës, përfshirë këtu dhe strukturat mbështetëse. Rrjedhimisht, pozicionet e këshilltarëve ligjorë, stafi i

qendrës së dokumentacionit dhe stafit administrativ, janë njësoj të rëndësishëm për funksionimin e mirë të Gjykatës së Lartë. Lidhur me këtë, duhet të marrim në konsideratë, me prioritet, këto hapa:

Së pari, siguroni që të ekzistojnë të gjithë aktet e nevojshme nënligjore që mundësojnë caktimin e menjëhershëm të këshilltarëve ligjorë që diplomohen në Shkollën e Magjistraturës;

Së dyti, hapni procedurat e komandimit për ndihmësmagjistratë;

Së treti, miratoni rregulloren e brendshme standard të kërkuar për Gjykatën e Lartë, në mënyrë që kjo gjykatë të mund të miratojë rregullat e saj dhe më të detajuara siç e parashikon ligji;

Së katërti, miratoni pa vonesë aktet nënligjore të kërkuara, që lejojnë njoftimin për hapjen e vendeve për stafin administrativ;

Së pesti, garantoni burimet e mjaftueshme financiare për 2020-ën, që e lejojnë Gjykatën e Lartë të punësojë dhe të plotësojë të gjithë vendet e lira në administratën e gjykatës, të punësojë stafe për qendrën e dokumentacionit, të punësojë sekretarë gjyqësorë dhe për të mbështetur përfundimin e vendimeve gjyqësore të marra, dhe garantoni burimet e mjaftueshme financiare për të gjithë vendet që duhen plotësuar për vitin 2021.

Është shumë e rëndësishme të theksojmë që të dy proceset, pra caktimi, ngritja në detyrë e gjyqtarëve dhe ngritja e strukturave mbështetëse administrative, të kryhen në të njëjtën kohë, për të garantuar mekanizma të mjaftueshëm mbështetës për numrin përkatës të gjyqtarëve në çdo fazë.

Së fundmi, në cilësinë e përfundimeve, funksionaliteti i një gjykate nuk përcaktohet ekskluzivisht nga numri i gjyqtarëve. Nëse nuk ekzistojnë strukturat e përgjithshme mbështetëse, gjykata mund të mos jetë funksionale edhe po të ketë një numër të madh të gjyqtarëve.

Pyetja nëse të gjithë pozicionet e lira duhet të hapen në të njëjtën kohë, duhet të marrë përgjigje nga analiza e elementëve të përshkruar më sipër. Në të gjithë aspektet e tij, parimi i funksionalitetit të Gjykatës së Lartë duhet të marrë në konsideratë dhe pasi të bëhet një vlerësim, të merret një vendim i mbështetur në informacione.

Gjithashtu kemi edhe në lidhje me pyetjet që duhet të ngre KLGJ-ja mbi, ngritjen në detyrë dhe strukturat mbështetëse gjyqësore, pra që t'i ketë parasysh:

A lejon numri i gjyqtarëve, që kanë kaluar të gjithë procesin e vlerësimit kalimtar, një konkurrencë të drejtë dhe shanse të barabarta për të gjithë gjyqtarët që i plotësojnë kushtet për ngritjen në detyrë? Nëse jo, çfarë mund ta lehtësojë këtë?

Duke pasur parasysh numrin e vogël të gjyqtarëve që aplikuan për gjashtë vakancat e shpallura në shkurt të 2020, a mund të rritet niveli i interesit për procedurën e ngritjes në detyrë? Nëse po, cili është mekanizmi i duhur për ta bërë këtë?

A janë realiste afatet kohore të paracaktuara nga rregullorja për ngritjen në detyrë?

A mund të përfundojë procedura e verifikimit brenda afateve të caktuara nga akti i ngritjes në detyrë, apo mund të ketë vonesa?

A kanë burime njerëzore të mjaftueshme në dispozicion komisionet përgjegjëse të përhershme? Nëse jo, si mund të veprohet më shumë mbështetje?

A operojnë me shpejtësinë e duhur institucionet të tjera ILDKPI, DSIK, etj.? Nëse jo, si mund të përmirësohet bashkëpunimi përmes marrëveshjeve ndërinstitucionale?

A nevojiten ndryshime të menjëhershme legislative në kodet e procedurave për të garantuar përmirësimin që rrisin rendimentin e gjyqtarëve dhe një rrjedhë më të mirë të punës? Nëse po, si mund të arrihet në kohë të shpejta?

A mjaftojnë mjetet e disponueshme financiare për të garantuar funksionalitet të efektshëm? Nëse jo, cili sektor, proces kërkon më shumë vëmendje dhe si mund të arrihen financat e nevojshme.”

Ky ishte edhe qëndrimi/mendimi i dhënë nga të dy partnerët tanë që na asistojnë. Unë ju ftoj për diskutim.

Alban Toro: Më fal, ky është i të dyve, apo është vetëm i USAID-it? Se unë shikoj vetëm logon e USAID-it dhe në fund është firmosur nga përfaqësuesi i USAID-it. Nuk e shoh EURALIUS-in këtu.

Naureda Llagami: Atëherë, po të lexojmë tek fillimi i praktikës...

Alban Toro: Po! Shkresa i është drejtuar të dy misionëve. Më pas, evolimi ose zhvillimi është bërë nga USAID-i, në mos jam i gabuar.

A mund të merrni konfirmim nëse është punë e përbashkët sepse firmosja e vetëm nga njëri nga partnerët, më lë të dyshoj që është vetëm produkt i USAID-it.

Naureda Llagami: I kemi “online” të dy partnerët dhe mund të na i konfirmojnë.

Valbona Bala: Përshëndetje, jam Valbona!

Më dëgjoni?

Naureda Llagami: Po, Valbona!

Valbona Bala: Është opinion i përbashkët, por për shkak të protokolleve dhe të procedurave që kanë dy projektet, e kanë dërguar veçmas. Pra teksti, rekomandimet janë të njëjta, por dërguar veçmas nga dy shefet e misioneve. Ajo çfarë sapo lexoi Kryetarja është edhe opinion i Projektit “Drejtësi për të gjithë” edhe opinion i EURALIUS-it, është opinion i përbashkët, që mund ta konfirmojnë edhe kolegët e EURALIUS-it që janë duke ndjekur mbledhjen plenare.

Anisa Kuqi: Përshëndetje! Anisa nga EURALIUS.

Konfirmoj atë që Valbona tha. Ky është një opinion i përbashkët nga EURALIUS dhe USAID dhe do ta dërgojmë versionin tonë me logon tonë pak më vonë, në formë shkresore dhe elektronike.

Naureda Llagami: Shumë faleminderit!

Atëherë, kalojmë në diskutimin e çështjesh?

Po, zonja Ukperaj!

Brikena Ukperaj: në vijim të diskutimit që kam bërë edhe në mbledhjen e kaluar plenare, referuar asaj çka parashikohet në rezolutë por edhe në opinionin e misioneve, në këndvështrimin tim, hapja e numrit të pozicioneve të lira ose shpallja e numrit për ngritjen në detyrë, duhet e parë ngushtësisht me garantimin e funksionalitetit të Gjykatës së Lartë. Pra nuk është thjesht hapja tërësore, nuk mund të lexohet rezoluta dhe opinionin si thjesht një hapje tërësore e vendeve vakante, por si një hapje e vendeve vakante, për të garantuar funksionalitetin e Gjykatës së Lartë. Në këtë këndvështrim, për shkak edhe të arsyetimit të bërë edhe në mbledhjen e kaluar plenare, unë vazhdoj t’i qëndroj propozimit për hapjen vetëm të 5 vakancave në Gjykatën e Lartë, pra 5 pozicione të lira për ngritjen në detyrë dhe vlerësime nga ana e Këshillit në një të ardhme, lidhur me hapjen e tre

pozicioneve të lira. Kjo do të garantonte funksionalitetin e Gjykatës së Lartë, do të ruante edhe miradministrimin e niveleve të tjera të sistemit gjyqësor dhe kryesisht të Gjykatës së Posaçme; do të garantonte një procedurë më të drejtë konkurrimi edhe për gjyqtarët e tjerë që do duan të aplikojnë për Gjykatën e Lartë, pa e lidhur shumë më procesin e vettingut; nga ana tjetër, për shkak edhe të ngarkesës së punës, ndoshta do ta bënte Këshillin më eficient në mbushjen në një kohë më të shpejtë të vakancave të shpallura. Kështu që vazhdoj t'i qëndroj propozimit për hapjen e 5 vendeve vakante.

Lidhur me fushat ose pozicionet specifike, unë kam ngritur propozimin që ato të jenë 4 penale dhe 1 administrative, për të ruajtur ose për të garantuar funksionimin e kolegjeve me 5 gjyqtarë të specializuar të fushave përkatëse. Vazhdoj t'i qëndroj këtij propozimi.

Nëse nga kolegët do të ketë propozime të tjera pastaj, lidhur me mënyrën se si do të bëhet ndarja e 5 pozicioneve në fushat specifike, le të diskutojmë. Por qëndrimi im është që të hapen vetëm 5 vende të lira për procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë.

Naureda Llagami: Faleminderit, zonja Ukperaj!

Ndonjë koleg tjetër, e kërkon fjalën?

Brunilda Kadi: Kërkoj unë fjalën Kryetare!

Naureda Llagami: Po, Bruna!

Brunilda Kadi: Atëherë edhe unë dua shkurt të them që i qëndroj edhe unë të njëjtës ide që kisha seancën e kaluar plenare. Nuk po e përsëris. Pra unë jam që të hapen të gjitha vendet dhe mendoj që për shumë arsye, sot nisur nga ajo çfarë kemi arsyetuar që ne kemi 19 vende gjithsej në Gjykatën e Lartë, ku gjithmonë një nga pozicionet do jetë jofunksional pasi do jetë gjithmonë anëtar i Këshillit. I bie që ne kemi 18 vende që do funksionojë Gjykata e Lartë, nëse do jetë me këtë numër. Duke qenë se kemi tre kolegje, unë vlerësoj që të tre kolegjet duhet të kenë numër të barabartë gjyqtarësh, edhe për shkak të ndarjes nëpër trupa gjykues, që Gjykata e Lartë gjykon me tre gjyqtarë normalisht. Mendoj që nuk bën sens nga ana matematikore, që ne ta ndryshojmë këtë raport sepse nuk bën sens që për shembull të kemi dy gjyqtarë më shumë në civile,

meqenëse nga statistikat dhe është fakt i njohur që civilja ka më shumë ngarkesë, të ketë dy gjyqtarë më tepër në atë kolegji, pasi nuk do formoheshë trupi gjykues, që do të thotë që në atë treshe, gjithmonë do futet një gjyqtar nga një kolegji tjetër. Për më tepër, ne siç e dimë, sot faktikisht Gjykata e Lartë ka tre gjyqtarë, që gjykojnë të treja llojet e çështjeve dhe ata i përkasin tre pozicioneve të ndryshme. Kështu që, për të mos e përsëritur, përfundimisht unë jam që të hapen të gjitha vendet, nisur nga ato çfarë kemi hapur, të hapim pozicionet duke i bërë të barabarta të treja pozicionet, pra me nga gjashtë gjyqtarë secili. Kaq kisha. Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit, Bruna!

Marçela Shehu: Mund të flas Kryetare?

Naureda Llagami: Po, Marçela!

Marçela Shehu: Faleminderit!

Në mbledhjen e kaluar, unë isha një nga anëtarët që bëri një propozim lidhur me shpalljen e vendeve në Gjykatën e Lartë, duke propozuar që deri në fund të korrikut, nga ana e Këshillit, të hapeshë thirrja për 5 pozicione të lira në Gjykatën e Lartë dhe konkretisht, 4 pozicione në fushën e së drejtës penale dhe 1 pozicion në fushën e së drejtës administrative, ndërkohë që për tre pozicionet e tjera të mbetura, që sipas vlerësimit tim duhet të ndaheshin nga një në secilën fushë, pra një në penale, një në administrative dhe një në civile, kjo shpallje të bëheshe por me një afat më të gjatë, në propozimin tim, deri në fund të tetorit, por gjithsesi duke lënë dhe në vlerësim dhe në diskutim të gjithë anëtarëve të tjerë të Këshillit.

Sot, unë i qëndroj pak a shumë të njëjtit variant, por duke konsideruar edhe ato ç'kanë propozuar të dy misionet në raportin dhe në propozimet e paraqitura dhe në veçanti duke vlerësuar dhe duke i vënë theksin edhe problemit të "becklog"-ut që ekziston sot në Gjykatën e Lartë, ku në raport janë ndarë me përqindje, por nëse do i përkthejmë në shifra, rezulton që sot Gjykata e Lartë rezulton të ketë një "becklog" me mbi 18 mijë çështje që i përkasin fushës të së drejtës civile, rreth 12 mijë çështje që i përkasin fushës administrative dhe rreth 5 mijë çështje që i përkasin fushës të së drejtës penale, unë do të rivlerësoja edhe një herë propozimin duke i qëndruar numrit të

pozicioneve që duhet të shpallim deri në fund të korrikut, duke i qëndruar numrit 5, por duke bërë një rivlerësim të secilës fushë të cilës duhet t'i përkasin këto pozicione.

Unë do propozoja që, me qëllim krijimin e dy trupave gjykues, për t'i dhënë edhe një frymëmarrje çështjes së “becklog”-ut lidhur me çështjet civile, ne të shpallim edhe 1 pozicion në fushën e së drejtës civile dhe në këtë mënyrë numri i gjyqtarëve në këtë fushë do të shkonte në 6, pra do të krijoheshin dy trupa gjykues, duke i dhënë kështu një lehtësim çështjes së “becklog”-ut, ndërkohë që të shpallim 3 pozicione në fushën e së drejtës penale dhe 1 pozicion në fushën e së drejtës administrative, kjo për sa i përket periudhës së korrikut.

Për tre pozicionet e tjera të mbetura, unë do i qëndroj propozimit dhe idesë që kisha që në mbledhjen e kaluar, që ne të kishim një ndarje të barabartë të gjyqtarëve me qëllim krijimin e trupave gjykues dhe me këtë propozim të ri unë do propozoja tashmë që 2 pozicionet në fushën e së drejtës penale dhe 1 pozicion në fushën e së drejtës administrative që mbeten pa u shpallur, të shpallen tani me një afat më të gjatë ose nëse Këshilli do që ta rivlerësojë edhe një herë situatën në shtator, mund edhe që të shtyjme këtë shpallje në shtator, për të bërë një rivlerësim të situatës edhe një përcaktim më të qartë të afatit të kësaj shpalljeje. Ky është propozimi im për hapjen e pozicioneve në Gjykatën e Lartë, duke konsideruar edhe të gjitha ato rekomandime të drejta, të dhëna nga të dyja misionet. Faleminderit, Kryetare!

Naureda Llagami: Faleminderit, Marçela!

Atëherë, deri tani kemi 3 propozime.

Ndonjë koleg tjetër?

Atëherë, nëse nuk kemi ndonjë diskutim, unë do filloja me hedhjen në votim lidhur me numrin e pozicioneve që do duam të hapim në Gjykatën e Lartë.

Kemi propozimin e parë të bërë nga zonja Ukperaj, i cili është që të hapen 5 pozicione në Gjykatën e Lartë dhe 3 pozicionet e tjera të hapen në një moment tjetër...

Brunilda Kadi: Kryetare, më fal!

Kam përshtypjen që në fillim duhet të hidhet në votim propozimi im sepse përfshin numër më të madh dhe në qoftë se bie ai, të kalojmë në variantet e tjera. Mendoj që logjikisht ky është propozimi që duhet të hidhet i pari. Megjithatë, vlerësojeni!

Naureda Llagami: E nisa nga më i vogli tek më i madhi.

Kemi dy propozime në fakt që është Brikena dhe Marçela që janë në një numër të kufizuar, 5. Marçela e ndryshoi sot dhe tha 6.

Marçela Shehu: Jo! Nuk e ndryshova.

Unë i qëndroj numrit 5 si në mbledhjen e kaluar. Vetëm bëra një ripropozim lidhur me ndarjen në secilën fushë të së drejtës, pra duke propozuar shpalljen e 3 pozicioneve në fushën e së drejtës penale, 1 në fushën e së drejtës administrative dhe 1 në fushën e së drejtës civile, por duke bërë shpalljen në vlerësimin tim edhe për tre pozicionet e tjera të mbetura, por me një afat më të gjatë. Ndërsa, deri në fund të korrikut numri është 5 edhe nga ana ime. Vetëm kemi një rindarje, pra jo 4 penale dhe 1 administrative, por 3 penale, 1 administrative, 1 civile.

Naureda Llagami: Janë dy me pesë, kështu që, fillojmë me propozimin që do hapen 5.

Brunilda Kadi: Më fal Kryetare që po ndërhyj, sepse e bën të vështirë votimin për mua, për shembull që kam propozuar të hapen të gjitha vendet. Pse? Sepse unë nuk mund të votoj kundër propozimit, qoftë të Marçelës apo të Brikenës sepse kam një ide tjetër. Mbasi të rrëzohet ajo ideja/propozimi im për hapjen e të gjitha vendeve, unë pastaj kam mundësinë të votoj për variante të tjera. Kështu që unë mendoj që në fillim duhet të hidhet në votim propozimi im. Le të mos ndahen pozicionet, thjesht propozimi im është që të hapen të gjitha vendet që sot janë vakant. Nëse bie ky propozim, pastaj kalojmë me radhë.

Marçela Shehu: Kam unë një pyetje për Brunën nëse më lejohet.

Propozon hapjen e të gjitha vendeve dhe shpalljen e tyre në të njëjtën kohë apo i qëndron një ndarje lidhur me afatin?

Brunilda Kadi: Atëherë, që ta formuloj unë propozimin tim saktë.

Unë propozoj që të hidhet në votim që të hapen të gjitha vendet që janë vakant dhe me afat 2 ose 3 javë, jo me afate të ndryshme, se unë mendoj se lënia e një afati më të gjatë në fund të ditës është mos hapja e atij vendi sepse ti do presësh të mbarojë afati që të vlerësosh kandidaturat. Atëherë, formulimi i propozimit tim është që të hapen të gjitha vendet që janë sot vakant në Gjykatën e Lartë, që janë 8 pozicione, me afat kandidimi 2-javor. Nëse bie ky propozim, pastaj të hidhen me radhë propozimet siç janë, që edhe ata që janë në pozicionin që jam unë, të kenë mundësi të votojnë.

Naureda Llagami: Po, Bruna!

Po fillojmë me propozimin e Brunës, pra për hapjen e të gjithë vendeve vakante në Gjykatën e Lartë, me një afat 2-javor shpalljeje.

E hedhim në votim.

Maksim Qoku: Kundër, me atë klauzolën që përmenda edhe radhën e kaluar që shtyrja e tre vendeve për t'u hapur në një kohë më të vonshme do na ndihmonte që të matnim "becklog"-un se si do të kishte ecurinë e tij gjatë kohëvazhdimet. Faleminderit!

Brunilda Kadi: Pro.

Dritan Hallunaj: Kundër.

Ilir Toska: Kundër.

Alban Toro: Kundër.

Fatmira Luli: Kundër.

Marçela Shehu: Unë jam dakord hapjes/shpalljes të të gjitha vendeve të lira në Gjykatën e Lartë, por jam pjesërisht kundër lidhur me afatin, pra për tre pozicionet, vlerësimi im është që ato duhet të shpallen për një afat më të gjatë kandidimi. Pra jam pjesërisht kundër.

Erjon Muharremaj: Kundër.

Brikena Ukperaj: Kundër.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, kalojmë në propozimin tjetër, i cili ka të bëjë me propozimin e zonjës Ukperaj që të hapen vetëm 5 vende...

Brunilda Kadi: Jo!

Më fal Kryetare, tani duhet të jetë i Marçelës. Edhe Marçela tha të gjitha, por me afate të ndryshme. Pastaj vjen i Brikenës sepse është për më pak vende. Kështu që, të shikojmë si do ecë votimi me Marçelën, pastaj kalojmë tek propozimi i Brikenës, se mua kështu më bën sens.

Brikena Ukperaj: Mund të ndërhyj pak zonja Kryetare?

Në fakt, propozimi im dhe i Marçelës bashkohet në pikën që duhet të hapen 5 pozicione aktualisht, me afat si ta vlerësojë Këshilli, ndoshta deri në fund të korrikut, dhe Marçela ka propozimin që tre vende të hapen edhe ato, pra të shpallen sot, por afati i kandidimit të jetë i gjatë, ndoshta deri në fund të muajit korrik, siç propozoi Marçela – në fund të muajit tetor, -më falni.

Ndërsa propozimi im është që të shpallim 5 vende vakante sot dhe për shpalljen e tre të tjerave të vendosen në një moment të mëvonshëm. Për këtë arsye mendoj që duhet të hidhet propozimi i Marçelës.

Brunilda Kadi: Brikena, më fal, pra ti ndryshon nga Marçela vetëm për faktin që ti thua që tre pozicionet, po t'i shpallim më vonë, do të dimë se në çfarë fushe do t'i hapim? Sepse propozimi i Marçelës është që ne do ta dimë që tani, se përderisa do t'i hapim, apo jo? Kjo është diferenca.

Brikena Ukperaj: Pikërisht. Do të kemi një rivlerësim tjetër, por edhe për faktin që edhe ju Bruna e thatë, në fakt shtyrja e afatit deri në fund të muajit tetor, në thelb është një rishpallje.

Brunilda Kadi: Po, po!

Pra ti ndryshon nga propozimi i Marçelës vetëm për pjesën që tre pozicionet e fundit do t'i caktojmë nga shtatori ose në një kohë të afërt.

Brikena Ukperaj: Do t'i shpallim në një të ardhme, që mund të jetë shtator ose mesi i tetorit. Si ta vlerësojë Këshilli.

Maksim Qoku: Në një moment të dytë.

Brikena Ukperaj: Po! Në një moment të dytë.

Maksim Qoku: E pra, kjo është ideja.

Tani më lini të saktësoj diçka.

Unë kam idenë që ti dhe Marçela ndryshoni edhe tek numri. Më duket Brikena ju thoni 4 penale dhe...

Brikena Ukperaj: Maksim, kjo do jetë një votim tjetër.

Brunilda Kadi: Atëherë, të hidhet i Marçelës në fillim, se është, le të themi, si bashkësi më e madhe ajo që propozon Marçela, po ta mendojmë kështu si grafikisht.

Naureda Llagami: Atëherë, a bëjmë një formulim që: A jemi dakord që të shpallim 5 vende vakante me afat deri në fund të korrikut sepse ky është elementi që i bashkon edhe Marçelën edhe Brikenën. Kështu, hedhim këtë dhe më pas...

Brunilda Kadi: Jo, jo! Kryetare, le ta formulojë vetë Marçela propozimin, që ta kemi të qartë tani çfarë po votojmë.

Marçela Shehu: Kryetare, propozimi është pak më i gjerë se numri 5, ku bashkohem me Brikenën. Propozimi është që 5 pozicione të shpallen me afat deri në fund të korrikut ndërsa 3 pozicionet e mbetura, unë kërkoj të shpallen, madje bëra edhe një propozim për fushën përkatëse, duke e lidhur me barazinë e trupave gjykues, duke shpallur 2 pozicione në fushën penale dhe 1 administrative, deri në fund të tetorit. Ky është propozimi im konkret, që edhe unë vlerësoj që duhet të hidhet në fillim në votim, pasi është më i përgjithshëm.

Naureda Llagami: Po, Ilir!

Ilir Toska: Këshilli, mbi propozimin e zonjës Kadi vendosi pak më herët që nuk do të hapim 8 pozicione të lira.

Të dy propozimet që ka edhe Brikena edhe Marçela që të hapen 5 pozicione. Pra ka ngelur një variant tjetër për sa i përket numrit të pozicionit që Këshilli duhet të hapë, të

jenë 5 (insistojnë të dy koleget që të hapen). Pra, në pikëpamje të numrave kemi vetëm një propozim të dytë, që të hapen 5 pozicione. Ky mendoj që është ajo që duhet të votojmë, nëse duhet të hapim tashmë sot 5 pozicione të lira për në Gjykatën e Lartë.

Nga ana tjetër, të dy koleget kanë alternativa të ndryshme sa i përket fushave të së drejtës për këto 5 pozicione. Nëse ne votojmë që do hapim 5, atëherë do të kemi prapë një votim për fushat e së drejtës. Pra ajo që mendoj në fund është që i vetmi propozim që kemi për të votuar është propozimi që të hapim 5 pozicione të lira. Nuk kemi alternativë tjetër, propozim tjetër për numrin e pozicionit. Për fushat kemi dy propozime të ndryshme që do duhet të votojmë përsëri.

Marçela Shehu: Dua të sqaroj komentit e Ilirit prandaj.

Unë jam dakord, domethënë propozimi im është që numri i pozicioneve të shpallura në korrik të jetë 5, por ama unë i qëndroj propozimit që 3 pozicionet e tjera të shpallen sot, por me një afat më të gjatë. Kështu që mendoj që edhe kjo duhet të votohet.

Ilir Toska: Marçela, të lutem!

Ne e votuam atë. U hodh propozimi që kishte Bruna dhe tha të hapen 8.

Këshilli votoi. Ju ishit pjesërisht dakord.

Marçela Shehu: Ah po!

Po, po! Dakord!

Ilir Toska: Është ezauruar numri 8.

Numri tjetër që është propozuar është numri 5.

Marçela Shehu: Ke të drejtë!

Naureda Llagami: Erjon!

Erjon Muharremaj: Faleminderit, zonja Kryetare!

Në vlerësimin tim, edhe propozimi për numrin 5 konsiderohet i ezauruar, sa kohë që kishim tre propozime, një për 8 pozicione dhe dy të tjerë për 5. Përderisa u votua kundër për 8-ën, tani ka ngelur vetëm 5-sa. Në vlerësimin tim, çka mbetet për t'u

diskutuar tani është që nga këto të 5-të cila do të jetë ndarja. Kjo ka mbetur për t'u vendosur nga Këshilli, në gjykimin tim. Faleminderit!

Naureda Llagami: Erjon, ke të drejtë. Por ne duhet formalisht të votojmë numrin 5. Nëse Këshilli pranon që deri në fund të këtij muaji do hapim 5 pozicione të lira, duhet ta kalojmë në votim.

Atëherë, hedhim në votim propozimin që Këshilli do hapi 5 pozicione të lira vakante në Gjykatën e Lartë, me afat brenda muajit korrik.

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Dakord. Pra 5 vende pa i përcaktuar pozicionet tani? Po votojmë vetëm për numrin?

Naureda Llagami: Vetëm për numrin Bruna.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ilir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi hapjen e 5 vendeve vakante në Gjykatën e Lartë.

Tani do diskutojmë lidhur me fushat e së drejtës të cilat do hapen këto vende vakante. Konkretisht, nga zonja Shehu kemi një propozim, e cila thotë që do hapen 3 në fushën e së drejtës penale, 1 në fushën e së drejtës civile dhe 1 në fushën e së drejtës administrative. Më pas kemi edhe një propozim të bërë nga zonja Ukperaj e cila thotë që të hapen 4 në fushën e së drejtës penale dhe 1 në fushën e së drejtës administrative.

Kështu, hedhim në votim secilën nga këto propozime.

Kalojmë propozimin e zonjës Ukperaj, 4 në penale dhe 1 në administrative.

Jeni dakord?

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Kundër.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ilir Toska: Kundër.

Alban Toro: Kundër.

Fatmira Luli: Pro.

Marçela Shehu: Kundër.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Kundër.

Naureda Llagami: Pro.

(6 pro dhe 5 kundër.)

Atëherë, miratohet propozimi i bërë nga zonja Ukperaj, pra që do hapim 5 vende tashmë, 4 në fushën penale dhe 1 në administrative.

Tani, çështja tjetër që kemi është lidhur me afatin e kandimit.

Nga propozuesja kemi ndonjë ide se sa do jetë afati, ose ndonjë koleg tjetër?

Brunilda Kadi: Më fal, Kryetare!

Kur votuam pesëshen, propozimi nga të dyja anëtarët ishte se afati i kandidimit ishte deri në fund të korrikut. Kështu e kuptuam votimin. Apo jo?

Naureda Llagami: Bruna, brenda korrikut kemi thënë por thamë ta bëjmë konkrete tani. Mos ta themi brenda korrikut. Të vëmë një datë, javë

Brunilda Kadi: U kuptua fundi i korrikut. Megjithatë, okej! Të saktësohet!

Naureda Llagami: Nuk diskutohet. Se votimi është për brenda korrikut, por të them me datë. Jemi sot data 9 korrik dhe të themi kur do jetë afati i dorëzimit të aplikimeve.

Maksim Qoku: Të kihet parasysh, të jetë një afat i logjikshëm, që të kenë mundësi të futen dokumentet.

Naureda Llagami: Bëni një propozim Maksi!

Marçela Shehu: 31 korrik. 2 javë është minimumi nga ligji.

Brikena Ukperaj: Unë propozoj në fakt që të jetë i njëjti afat kandidimi që ne kemi aktualisht për 2 pozicionet e lira që presin, 1 në civile dhe 1 në administrative. Për pozicionet e treta që kemi hapur, për civile dhe administrative, ne kemi afatin e fundit të kandidimit në datën 30 korrik. E njëjta datë vlerësoj që të jetë edhe për këto pozicione të reja që shpallim sot.

Naureda Llagami: Atëherë, e hedhim në votim propozimin e bërë nga zonja Ukperaj, mbi afatin e kandidimit, të jetë data 30 korrik për këto 5 pozicione?

Brunilda Kadi: Më fal, Brikena! Përpara se të hidhet në votim, mos konfondohen pastaj me datat, duket sikur është i njëjti. Mendoje edhe një herë si kasus.

Brikena Ukperaj: Vendimet janë me numra Bruna.

Brunilda Kadi: Mos konfondohen nga ana praktike. Mos ngatërrohen, a është i njëjti...

Brikena Ukperaj: Edhe nga ana praktike, edhe për punën e Komisionit më pas, është e mira që afati, për të gjitha pozicionet, të mbarojë në të njëjtën kohë, që të fillojnë edhe procedurat më pas. Kjo ishte arsyeja për të cilën propozova që të kishin një afat.

Brunilda Kadi: Okej! Mirë!

Naureda Llagami: Atëherë, jemi dakord, ta hedhim në votim propozimin?

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Dakord.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ilir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, edhe një herë, Këshilli vendosi hapjen e 5 pozicioneve, me një afat kandidimi deri më datë 30 korrik 2020. Nga këto 5 pozicione, 4 pozicione janë në të drejtën penale dhe 1 pozicion në administrative.

* * *

(Pika 3 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2020

PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 09.07.2020)

Pika 4 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit dhe relacionit për gjendjen e faktit dhe ligjin e zbatueshëm në lidhje me verifikimin e tre prej kritereve ligjore të kandidimit për gjyqtar në Gjykatën e Lartë, nga radhët e gjyqtarëve, të kandidatit z. {...}, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relatore – Marçela Shehu).

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:00 dhe mbaroi në orën 13:30.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Maksim Qoku*** (zëvendëskryetar)
3. ***Medi Bici*** (anëtar)
4. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
5. ***Brunilda Kadi*** (anëtare)
6. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
7. ***Ilir Toska*** (anëtar)
8. ***Alban Toro*** (anëtar)
9. ***Brikena Ukperaj*** (anëtar)
10. ***Erjon Muharremaj*** (anëtar)

Merrnin pjesë gjithashtu:

- 1. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
- 2. Elis Kuçi, Specialist pranë Drejtorisë së Marrëdhënieve me Publikun, me Jashtë dhe Botimet.*
- 3. Pjesë nga stafi administrativ i KLGJ-së (nëpërmjet platformës).*
- 4. Entela Dobi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë (nëpërmjet platformës).*
- 5. Përfaqësues të misioneve EURALIUS dhe USAID (nëpërmjet platformës).*

RENDI I DITËS:

4. Shqyrtimi i projektvendimit dhe relacionit për gjendjen e faktit dhe ligjin e zbatueshëm në lidhje me verifikimin e tre prej kriterëve ligjore të kandidimit për gjyqtar në Gjykatën e Lartë, nga radhët e gjyqtarëve, të kandidatit z. {...}, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relatore – Marçela Shehu).

Naureda Llagami: Atëherë, kalojmë tek çështja e radhës.

Në fakt kemi një spostim të çështjeve. Do të propozova që të kalonim për diskutim nga ana e Këshillit të çështjes për sa i përket projektvendimit dhe relacionit për gjendjen e faktit dhe ligjin e zbatueshëm në lidhje me verifikimin e tre prej kriterëve ligjore të kandidimit për gjyqtar në Gjykatën e Lartë, nga radhët e gjyqtarëve, të kandidatit z. {...}. Dhe më pas vijojmë me radhën. Kështu që fjalën do ia jepja relatores, zonjës Marçela Shehu.

Marçela Shehu: Me mbështetjen tuaj, po e përmbledh relacionin lidhur me kandidatin, duke qenë se ju e keni kohë që e keni relacionin dhe jeni njohur me të dhe me të dhënat që përmban ky relacion.

Zoti {...} ka kandiduar për një pozicion në Gjykatën e Lartë, në fushën e së drejtës civile, konkretisht për pozicionin e shpallur me vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor me nr. 86, datë 26.02.2020. Pas fillimit të procedurës, bazuar në rregulloren përkatëse, është vijuar procedura e verifikimit lidhur me tre kriteret e kandidimit për këtë kandidat,

konkretisht verifikimi i “përvojës profesionale minimale”, të “mospasjes së masës disiplinore në fuqi” dhe të “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale”.

Nga verifikimi i kryer bazuar në të dhënat dhe dokumentacionin që ju e keni gjerësisht të relatuar në relacionin përkatës, rezulton se kandidati z. {...} përmbush “përvojën minimale profesionale”, pasi rezulton të ketë mbi 13 vjet gjyqtar në gjykatat e nivelit më të ulët. Rezulton që përmbush edhe kriterin e “përvojës profesionale specifike”, pasi rezulton të ketë mbi 5 vjet përvojë në fushën e së drejtës civile. Rezulton gjithashtu se kandidati plotëson edhe të dy kriteret e tjera për “mospasjen e masës disiplinore në fuqi” dhe të “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale”, duke qenë se nuk kanë rezultuar të dhëna që të vënë në dyshim këto kritere.

Në këto kushte, me cilësinë e relatore, i propozoj Këshillit të Lartë Gjyqësor: 1. Verifikimin e plotësimin nga kandidati z. {...}, në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, për pozicionin e lirë në fushën e së drejtës civile, të shpallur me Vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 86, datë 26.02.2020, të kritereve të “përvojës profesionale minimale”, të “mospasjes masë disiplinore në fuqi” dhe të “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale”.

2. Vijimin e procedurës së verifikimit të kandidatit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit. Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit, zonja Shehu!

Kemi ndonjë diskutim?

Nëse jo, kalojmë në votimin, duke filluar sipas rregullores nga relatorja, anëtarët e Komisionit të Zhvillimit të Karrierës dhe më pas anëtarët e Këshillit.

Marçela Shehu: Dakord.

Illir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Dakord.

Dritan Hallunaj: Pro.

Fatmira Luli: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi: 1. Verifikimin e plotësimit nga kandidati z. {...}, në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me Vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 86, datë 26.02.2020, të kriterëve të “përvojës profesionale minimale”, të “mospasjes masë disiplinore në fuqi” dhe të “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale”. 2. Vijimin e procedurës së verifikimit të kandidatit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me Vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 86, datë 26.02.2020. 3. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidatit z. {...} sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e publikimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 4 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2020

PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 09.07.2020)

Pika 5 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për fillimin e procedurës së përshpejtuar të detyruar të vlerësimit etik dhe profesional viti kalendarik 2019, për gjyqtarët që kanë plotësuar kriteret ligjore të kandidimit për ngritje në detyrë”, i përgatitur nga Komisioni për Vlerësimin Etik dhe Veprimtarisë Profesionale.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:00 dhe mbaroi në orën 13:30.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. *Naureda Llagami* (kryetare)
2. *Maksim Qoku* (zëvendëskryetar)
3. *Medi Bici* (anëtar)
4. *Fatmira Luli* (anëtare)
5. *Brunilda Kadi* (anëtare)
6. *Dritan Hallunaj* (anëtar)
7. *Ilir Toska* (anëtar)
8. *Alban Toro* (anëtar)
9. *Brikena Ukperaj* (anëtar)
10. *Erjon Muharremaj* (anëtar)
11. *Marçela Shehu* (anëtare)

Merrnin pjesë gjithashtu:

1. *Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
2. *Elis Kuçi, Specialist pranë Drejtorisë së Marrëdhënieve me Publikun, me Jashtë dhe Botimet.*
3. *Pjesë nga stafi administrativ i KLGJ-së (nëpërmjet platformës).*
4. *Entela Dobi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë (nëpërmjet platformës).*
5. *Përfaqësues të misioneve EURALIUS dhe USAID (nëpërmjet platformës).*

RENDI I DITËS:

5. Shqyrtimi i projektvendimit "Për fillimin e procedurës së përshpejtuar të detyruar të vlerësimit etik dhe profesional viti kalendarik 2019, për gjyqtarët që kanë plotësuar kriteret ligjore të kandidimit për ngritje në detyrë", i përgatitur nga Komisioni për Vlerësimin Etik dhe Veprimtarisë Profesionale.

Naureda Llagami: Kalojmë me çështjen e radhës së rendit të ditës e cila ka të bëjë me fillimin e procedurës së përshpejtuar të detyruar të vlerësimit etik dhe profesional për vitin kalendarik 2019, për gjyqtarët që kanë plotësuar kriteret ligjore të kandidimit për ngritje në detyrë. Për më shumë detaje, fjalën ia jap zonjës Brikena Ukperaj.

Brikena Ukperaj: Faleminderit, zonja Kryetare!

Relacioni, duke qenë se është i detajuar lidhur me shpjegimet e të gjitha procedurave që janë ndjekur deri tani nga ana e Këshillit të Lartë Gjyqësor, unë do të bëj thjesht një përmbledhje të përmbajtjes dhe të arsyeve, për të cilat Komisioni i Vlerësimit të Etikës vjen sot në mbledhje plenare me këtë propozim.

Aktualisht nga ana e Këshillit të Lartë Gjyqësor janë verifikuar 3 kriteret ligjore të kandidimit për gjyqtarët që kanë aplikuar për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë dhe 4 kriteret ligjore të kandidimit për gjyqtarët që kanë aplikuar për ngritjen në detyrë në Gjykatat e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar. Gjithsej kemi 12 kandidatë të verifikuar, duke përfshirë edhe zotin {...} që sapo u miratua nga ana e Këshillit, pra kemi 12 kandidatë të verifikuar për 3 kriteret ligjore për pozicionet e lira për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë dhe njëkohësisht kemi edhe 3 kandidatë

të verifikuar për pozicionet e lira në Gjykatën e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar dhe 1 kandidat që ka kaluar procedurën e verifikimit gjithashtu për pozicionin e shpallur në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

Referuar skemës së vlerësimit të gjyqtarëve dhe akteve nënligjore që ne kemi miratuar për plotësimin e kësaj skeme, Këshilli duhet të fillojë procedurën e përshpejtuar të detyruar të vlerësimit etik dhe profesional për të gjithë kandidatët e verifikuar, të cilët kanë ushtruar funksionin e gjyqtarit në periudhën e vlerësimit që përfshin vitin kalendarik 2019.

Nga lista e kandidatëve të verifikuar, për efekt të vlerësimit etik dhe profesional për vitin e fundit kalendarik, Komisioni ka vlerësuar se zonja {...} duhet të përjashtohet, për arsye sepse ajo nuk e ka ushtruar funksionin e gjyqtarit këtë vit kalendarik, prandaj edhe nuk mund t'i bëhet vlerësim i përshpejtuar i detyruar.

Në këtë kuadër, në mbështetje të ligjit 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve”, neni 95 dhe 97 të këtij ligji, nenit 25 të ligjit nr. 48/2019 “Për disa ndryshime në ligjin 96/2016...”, si dhe vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 263, datë 21.11.2019 “Për miratimin e rregullave plotësuese të vlerësimit të gjyqtarëve”, pas përfundimit të procedurës së verifikimit për plotësimin e tre kriterëve ligjore të kandidimit për 11 gjyqtarët që kanë aplikuar për ngritje në detyrë në Gjykatën e Lartë (pa përfshirë znj. {...}) dhe përfundimit të procedurës së verifikimit për plotësimin e katër kriterëve ligjore të kandidimit për 4 gjyqtarët që kanë aplikuar për ngritje në detyrë në Gjykatat e Posaçme, i propozohet sot Mbledhjes Plenare, fillimi i procedurës së vlerësimit etik dhe profesional me procedurë të përshpejtuar, që përkon me vitin kalendarik 2019).

Ky vlerësim do të bazohet mbi të njëjtat burime vlerësimi të parashikuara në nenin 77 të ligjit për Statusin si dhe mbi bazën e rregullave të miratuara nga ana e Këshillit me vendimet nr. 263 dhe 264 të datës 21.11.2019.

Në relacion janë në mënyrë të detajuar emrat e të gjithë gjyqtarëve kandidatë dhe njëkohësisht respektivisht për secilin prej tyre është pasqyruar edhe vendimi përkatës. Unë do të lexoj vetëm emrat e kandidatëve, pasi me vendimet jemi të gjithë të njohur. I

kemii miratuar në mbledhjen plenare. Pra gjyqtarët që do t'i nënshtrohen procedurës së vlerësimit të përshpejtuar të detyruar, për vitin kalendarik 2019 janë: {..} – {...}.

Mbështetur sa më lart, Komisioni i propozon mbledhjes plenare miratimin e projektvendimit që ai ka përgatitur “Për fillimin e procedurës së përshpejtuar të detyruar të vlerësimit etik dhe profesional për gjyqtarët që kanë plotësuar kriteret ligjore të kandidimit për ngritje në detyrë në Gjykatën e Lartë dhe në Gjykatat e Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar”.

Pika I e projektvendimit përcaktohet pikërisht fillimin e kësaj procedure, ndërsa në pikën e II të projektvendimit përcaktohet caktimi i relatorit dhe nëpunësit përgjegjës për vlerësimin për secilin gjyqtar, proces i cili realizohet, sikundër kemi bërë edhe në procedurat e tjera, nëpërmjet shortit midis anëtarëve të Komisionit të Vlerësimit të Etikës për relatorin, dhe ndërmjet tre nëpunësve të Njësisë së Vlerësimit Etik dhe Profesional, për caktimin e nëpunësit përgjegjës për vlerësimin.

Në procedurën e shortit që do të zhvillohet për përzgjedhjen e relatorit, Komisioni ka vlerësuar që të ketë një shpërndarje të barabartë të punës midis tre anëtarëve të Komisionit dhe po i njëjti parim të zbatohet edhe për përzgjedhjen e nëpunësve përgjegjës për vlerësimin.

Në projektvendim përcaktohet gjithashtu edhe hyrja e tij në fuqi konkretisht me botimin në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Për të lehtësuar procedurat e shortit dhe për të fituar kohë, ne kemi propozuar, pasi jemi konsultuar edhe me stafin administrativ i cili na mbështet në këtë procedurë të realizimit të shortit, që në kushtet kur kemi 15 kandidatë gjyqtarë dhe kemi parimin e barazisë të shpërndarjes së punës, emrat e secilit prej anëtarëve relatorë të futen 5 herë në një vazo dhe po kështu emrat e nëpunësve përgjegjës për vlerësimin të futen 5 herë në një vazo tjetër. Kështu që do të kemi vetëm një procedurë shorti, ku mundësia e përzgjedhjes së relatorit dhe të nëpunësit përgjegjës të jetë e barabartë 5 kandidatë për secilin relator dhe për secilin nëpunës përgjegjës për vlerësimin. Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit, zonja Ukperaj!

Keni ndonjë diskutim?

Nëse jo, atëherë vijojmë me procedurën e shortit, sikurse e shpjegoi zonja Ukperaj, do kemi tre enë: në një enë do jenë kandidatët, në një enë tjetër do jenë nëpunësit përgjegjës dhe në enën tjetër do jenë relatorët.

Futen me radhë shiritat e letrës me emrat e kandidatëve: {...} – {...}.

Futen me radhë shiritat e letrës me emrat e nëpunësve përgjegjës për vlerësimin: Esmerilda Habili (5 shirita me emrin e saj futen në enën e qelqit), Fatbardh Çoniku (5 shirita me emrin e tij futen në enën e qelqit), Gilda Hoxha (5 shirita me emrin e saj futen në enën e qelqit).

Futen me radhë shiritat e letrës me emrat e anëtarëve relatorë: Brikena Ukperaj (5 shirita me emrin e saj futen në enën e qelqit), Brunilda Kadi (5 shirita me emrin e saj futen në enën e qelqit), Erjon Muharremaj (5 shirita me emrin e tij futen në enën e qelqit).

Sipas shortit rezulton: Kandidati {...}, nëpunës përgjegjës për vlerësimin znj. Esmerilda Habili, relatore znj. Brikena Ukperaj.

Kandidati {...}, nëpunës përgjegjës për vlerësimin znj. Esmerilda Habili, relator z. Erjon Muharremaj.

Kandidatja {...}, nëpunës përgjegjës për vlerësimin z. Fatbardh Çoniku, relatore znj. Brikena Ukperaj.

Kandadati {...}, nëpunës përgjegjës për vlerësimin znj. Esmerilda Habili, relatore znj. Brunilda Kadi.

Kandidatja {...}, nëpunës përgjegjës për vlerësimin znj. Gilda Hoxha, relatore znj. Brikena Ukperaj.

Kandidati {...}, nëpunës përgjegjës për vlerësimin znj. Gilda Hoxha, relatore znj. Brikena Ukperaj.

Kandidatja {...}, nëpunës përgjegjës për vlerësimin z. Fatbardh Çoniku, relatore znj. Brunilda Kadi.

Kandidatja {...}, nëpunës përgjegjës për vlerësimin znj. Gilda Hoxha, relatore znj. Brikena Ukperaj.

Kandidatja {...}, nëpunës përgjegjës për vlerësimin znj. Esmerilda Habili, relator z. Erjon Muharremaj.

Kandidati {...}, nëpunës përgjegjës për vlerësimin znj. Gilda Hoxha, relator z. Erjon Muharremaj.

Kandadati {...}, nëpunës përgjegjës për vlerësimin znj. Esmerilda Habili, relatore znj. Brunilda Kadi.

Kandidati {...}, nëpunës përgjegjës për vlerësimin znj. Gilda Hoxha, relatore znj. Brunilda Kadi.

Kandidatja {...}, nëpunës përgjegjës për vlerësimin z. Fatbardh Çoniku, relator z. Erjon Muharremaj.

Kandidatja {...}, nëpunës përgjegjës për vlerësimin z. Fatbardh Çoniku, relator z. Erjon Muharremaj.

Kandidatja {...}, nëpunës përgjegjës për vlerësimin z. Fatbardh Çoniku, relatore znj. Brunilda Kadi.

Naureda Llagami: Atëherë, kalojmë në votim të projekt-aktit, së bashku me shortin e hedhur.

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Dakord.

Dritan Hallunaj: Pro.

Illir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi: I. Fillimin e procedurës së përshpejtuar të detyruar të vlerësimit etik dhe profesional viti kalendarik 2019, për gjyqtarët që kanë plotësuar kriteret ligjore të kandidimit për ngritje në detyrë në Gjykatën e Lartë dhe në Gjykatat e Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

II. Caktimin e relatorit dhe nëpunësit përgjegjës për vlerësimin për secilin gjyqtar, si më poshtë:

1. Për gjyqtaren znj. {...} - Relator znj. Brunilda Kadi - Nëpunës përgjegjës për vlerësimin z. Fatbardh Çoniku.

2. Për gjyqtarin z. {...} - Relator znj. Brikena Ukperaj - Nëpunës përgjegjës për vlerësimin znj. Esmerilda Habili;

3. Për gjyqtarin z. {...} - Relator z. Erjon Muharremaj - Nëpunës përgjegjës për vlerësimin znj. Gilda Hoxha;

4. Për gjyqtarin z. {...} - Relator znj. Brikena Ukperaj - Nëpunës përgjegjës për vlerësimin znj. Gilda Hoxha;

5. Për gjyqtarin z. Klodian Kuruahi - Relator znj. Brunilda Kadi - Nëpunës përgjegjës për vlerësimin znj. Gilda Hoxha;

6. Për gjyqtaren znj. {...} - Relator znj. Brikena Ukperaj - Nëpunës përgjegjës për vlerësimin znj. Gilda Hoxha;

7. Për gjyqtaren znj. {...} - Relator z. Erjon Muharremaj - Nëpunës përgjegjës për vlerësimin znj. Esmerilda Habili;

8. Për gjyqtaren znj. {...} - Relator znj. Brikena Ukperaj - Nëpunës përgjegjës për vlerësimin z. Fatbardh Çoniku;

9. Për gjyqtaren znj. {...} - Relator z. Erjon Muharremaj - Nëpunës përgjegjës për vlerësimin z. Fatbardh Çoniku;

10. Për gjyqtarin z. {...} - Relator z. Erjon Muharremaj - Nëpunës përgjegjës për vlerësimin znj. Esmerilda Habili;

11. Për gjyqtarin z. {...} - Relator znj. Brunilda Kadi - Nëpunës përgjegjës për vlerësimin znj. Esmerilda Habili;

12. Për gjyqtarin z. {...} - Relator znj. Brunilda Kadi - Nëpunës përgjegjës për vlerësimin znj. Esmerilda Habili;

13. Për gjyqtaren znj. {...} - Relator z. Erjon Muharremaj - Nëpunës përgjegjës për vlerësimin z. Fatbardh Çoniku;

14. Për gjyqtaren znj. {...} - Relator znj. Brikena Ukperaj - Nëpunës përgjegjës për vlerësimin znj. Gilda Hoxha;

15. Për gjyqtaren znj. {...} - Relator znj. Brunilda Kadi - Nëpunës përgjegjës për vlerësimin z. Fatbardh Çoniku.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë me botimin në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 5 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2020

PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 09.07.2020)

Pika 6 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për mbarimin e statusit të magjistratit për gjyqtaren e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, znj. {...}” i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:00 dhe mbaroi në orën 13:30.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Maksim Qoku*** (zëvendëskryetar)
3. ***Medi Bici*** (anëtar)
4. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
5. ***Brunilda Kadi*** (anëtare)
6. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
7. ***Illir Toska*** (anëtar)
8. ***Alban Toro*** (anëtar)
9. ***Brikena Ukperaj*** (anëtar)
10. ***Erjon Muharremaj*** (anëtar)
11. ***Marçela Shehu*** (anëtare)

Merrnin pjesë gjithashtu:

1. *Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
2. *Elis Kuçi, Specialist pranë Drejtorisë së Marrëdhënieve me Publikun, me Jashtë dhe Botimet.*
3. *Pjesë nga stafi administrativ i KLGJ-së (nëpërmjet platformës).*
4. *Entela Dobi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë (nëpërmjet platformës).*
5. *Përfaqësues të misioneve EURALIUS dhe USAID (nëpërmjet platformës).*

RENDI I DITËS:

6. Shqyrtimi i projektvendimit “Për mbarimin e statusit të magjistratit për gjyqtaren e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, znj. {...}” i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Naureda Llagami: Kalojmë në çështjen tjetër të rendit të ditës e cila ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për mbarimin e statusit të magjistratit për gjyqtaren e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, znj. {...}”. Për më shumë detaje rreth projekt-aktit fjalën ia jap relatorit z. Alban Toro.

Alban Toro: Pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, më datë 16.06.2020 është depozituar një kërkesë me anë të komunikimit elektronik (protokolluar me nr.2833 prot..) nga gjyqtarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, znj. {...}, nëpërmjet të cilës ajo ka parashtruar dorëheqjen e saj nga statusi i magjistratit.

Njëkohësisht gjyqtarja znj. {...} ka informuar se të njëjtën përmbajtje e ka dërguar edhe me shkresë zyrtare nëpërmjet shërbimit postar amerikan, e cila pas verifikimit të kodit postar, na rezulton të jetë brenda territorit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, pra akoma nuk është nisur për në drejtim të Republikës së Shqipërisë. Në vijim të verifikimit të vullnetit të magjistrates në lidhje me dorëheqjen e saj, nga ana jonë është disponuar dhe video, pas kërkesës së bërë nga ana jonë, në mënyrë që të korrespondonte vullneti i gjyqtares, i verifikuar, për sa ajo ka deklaruar nëpërmjet e-mailit të saj.

Gjyqtarja {...} me Dekretin e Presidentit të Republikës nr.5474, datë 05.10.2007 është emëruar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë për të kryer stazhin profesional.

Me Dekret të Presidentit të Republikës nr.6104, datë 25.03.2009, ajo është caktuar gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kavajë.

Me Vendim nr. 419, datë 20.12.2013 të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, transferohet gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Me Vendim nr. 45, datë 22.09.2017 të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, i jepet leje prindërore për t'u shkëputur nga puna deri më datë 06.08.2020.

Në kërkesën e saj, gjyqtarja znj. {...} ka kërkuar që: "...mbarimi i mandatit të realizohet në parashikim nga neni 65/1 të ligjit nr.96/2016 i cili parashikon ndër të tjera se 1. Magjistrati mund të kërkojë mbarimin e statusit, nëpërmjet paraqitjes së dorëheqjes para Këshillit përkatës..”.

Në këto kushte, magjistratja kërkon duke u bazuar në vullnetin e saj, kërkon që të japë dorëheqjen nga funksioni i gjyqtarit, duke deklaruar edhe mbarimin e statusit.

Rasti është i ngjashëm me praktikat e tjera. Nga ana jonë është verifikuar vullneti i gjyqtares dhe rezulton që ajo e ka qartësuar dhe siguruar vullnetin pranë institucionit.

Në kushtet kur instituti i dorëheqjes është një akt vullnetar dhe nuk mund të jetë i kufizuar në kohë si dhe është prevalent ndaj çdo aspekti tjetër, kemi proceduar duke propozuar me projekt-draftin bashkëlidhur, ku në dispozitiv gjeni të sugjeruar:

Deklarimin e mbarimit të statusit të magjistratit për znj. {...}, gjyqtare e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, për shkak të dorëheqjes së saj.

Efektet e këtij urdhërimi fillojnë më datë 31.07.2020.

Një kopje e këtij vendimi i njoftohet gjyqtares znj. {...}, sipas kërkesave të shkronjës “b”, të pikës 1, të nenit 98, të Ligjit nr. 115/2016, si dhe bëhet publik në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.

Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit, në Gjykatën Administrative të Apelit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit, zoti Toro!

Atëherë, kemi ndonjë diskutim nga kolegët mbi projekt-aktin?

Nëse jo, e hedhim në votim?

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Dakord.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ilir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi: 1. Deklarimin e mbarimit të statusit të magjistratit për znj. {...}, gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, për shkak të dorëheqjes së saj. 2. Efektet e këtij urdhërimi fillojnë më datë 31.07.2020. 3. Një kopje e këtij vendimi i njoftohet gjyqtarës znj. {...}, sipas kërkesave të shkronjës “b”, të pikës 1, të nenit 98, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, si dhe bëhet publik në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve. 4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit, në Gjykatën Administrative të Apelit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 6 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2020

PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 09.07.2020)

Pika 7 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për rihapjen e procedurës së komandimit në zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe shpalljen e kërkesës për kandidatura nga radhët e gjyqtarëve”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:00 dhe mbaroi në orën 13:30.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Maksim Qoku*** (zëvendëskryetar)
3. ***Medi Bici*** (anëtar)
4. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
5. ***Brunilda Kadi*** (anëtare)
6. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
7. ***Illir Toska*** (anëtar)
8. ***Alban Toro*** (anëtar)
9. ***Brikena Ukperaj*** (anëtar)
10. ***Erjon Muharremaj*** (anëtar)
11. ***Marçela Shehu*** (anëtare)

Merrnin pjesë gjithashtu:

- 1. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
- 2. Elis Kuçi, Specialist pranë Drejtorisë së Marrëdhënieve me Publikun, me Jashtë dhe Botimet.*
- 3. Pjesë nga stafi administrativ i KLGJ-së (nëpërmjet platformës).*
- 4. Entela Dobi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë (nëpërmjet platformës).*
- 5. Përfaqësues të misioneve EURALIUS dhe USAID (nëpërmjet platformës).*

RENDI I DITËS:

7. Shqyrtimi i projektvendimit “Për rihapjen e procedurës së komandimit në zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe shpalljen e kërkesës për kandidatura nga radhët e gjyqtarëve”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Naureda Llagami: Kalojmë në çështjen tjetër të rendit të ditës e cila ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për rihapjen e procedurës së komandimit në zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe shpalljen e kërkesës për kandidatura nga radhët e gjyqtarëve”. Relatimi i projekt-aktit do të bëhet nga z. Ilir Toska.

Ilir Toska: Faleminderit!

Komisioni i Zhvillimit të Karrierës ka përgatitur projekt-aktin “Për rihapjen e procedurës së komandimit në zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe shpalljen e kërkesës për kandidatura nga radhët e gjyqtarëve”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, referuar nenit 86 të Ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së drejtësisë” i ndryshuar dhe në zbatim të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, është organi përgjegjës për emërimin, caktimin në pozicion, transferimin, ngritjen në detyrë, komandimin dhe riemërimin, vlerësimin e veprimtarisë etike dhe profesionale, vendosjen e masave disiplinore dhe pezullimin, si dhe çdo detyrë tjetër e caktuar me ligj.

Legjislacioni në fuqi, konkretisht Ligji nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, ka parashikuar edhe mundësinë e komandimit të magistratit, me pëlqimin e tij, në institucione të tjera brenda sistemit të

drejtësisë, përfshirë këtu dhe në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Gjithashtu në dispozitat e këtij ligji, konkretisht në nenet 54, 55, 57 dhe 58, përcaktohet edhe procedura që duhet të ndjekë Këshilli, ashtu dhe institucionet e tjera në të cilat magjistrati mund të komandohet, në këto raste.

Në lidhje me rastin në shqyrtim, pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor u depozitua shkresa nr. 5 prot., datë 29.01.2020, e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, përmes të cilës Këshilli iu kërkua komandimi i gjashtë magjistratëve gjyqtarë në pozicionin e inspektorit pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Për sa më lart, mbështetur në nenin 86, shkronja “d”, të Ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në nenet 53, 54, 55, 57 dhe 58 të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, bazuar në kërkesën e Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, Këshilli i Lartë Gjyqësor me propozim të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, Vendimin nr. 98, datë 26.02.2020, “Për hapjen e procedurës së komandimit në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe shpalljen e kërkesës për kandidatura nga radhët e gjyqtarëve”.

Në përfundim të afatit të pezulluar dhe më pas të zgjatur të kandidimit për shkak të situatës së shkaktuar nga Covid-19, pikërisht më datë 29 prill 2020, rezultoi të mos kishte kandiduar asnjë gjyqtar. Ky fakt u bë publik, përveçse iu njoftua zyrtarisht dhe Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Me shkresën nr. 1413 prot., datë 29.06.2020, protokolluar në Këshill me aktin nr. 3005 prot., datë 29.06.2020, Inspektori i Lartë të Drejtësisë i është drejtuar përsëri Këshillit të Lartë Gjyqësor, duke kërkuar rinisjen e procedurave për komandimin e tashmë 7 gjyqtarëve në pozicionin e inspektorit pranë këtij Institucioni.

Ndaj sa më sipër, mbështetur në të njëjtën bazë ligjore si më herët, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës ka propozuar Këshillit projektvendimin “Për rihapjen e procedurës së komandimit në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe shpalljen e kërkesës për kandidatura nga radhët e gjyqtarëve”.

Lidhur me përmbajtjen e projektvendimit, ai titullohet “Për rihapjen e procedurës së komandimit në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe shpalljen e kërkesës për kandidatura nga radhët e gjyqtarëve”.

Sa i përket përmbajtjes së projektvendimit, ai është i strukturuar në dy krerë, me të njëjtën përmbajtje, si dhe në rastin e hapjes fillimisht të procedurës për komandimin e gjyqtarit në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, me përjashtim të numrit të gjyqtarëve që kërkohet të komandohen për pozicionin inspektor, që në këtë rast është 7 gjyqtarë.

Së fundi, parashikohet se ky vendim hyn në fuqi menjëherë me botimin e tij në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit, zoti Toska!

Keni ndonjë sugjerim apo diskutim për projekt-aktin?

Nëse jo, kalojmë në votim të projekt-aktit sipas propozimit të bërë nga Komisioni?

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Dakord.

Dritan Hallunaj: Pro.

Illir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi miratimin e rihapjes së procedurës së komandimit në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe shpalljen e kërkesës për kandidatura nga radhët e gjyqtarëve, sipas propozimit të bërë nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

* * *

(Pika 7 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2020

PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 09.07.2020)

Pika 8 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për rishpalljen e kërkesës për kandidatura nga radhët e gjyqtarëve për komandim në Ministrinë e Drejtësisë, kohëzgjatjen, kriteret dhe procedurën e komandimit”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:00 dhe mbaroi në orën 13:30.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. *Naureda Llagami* (kryetare)
2. *Maksim Qoku* (zëvendëskryetar)
3. *Medi Bici* (anëtar)
4. *Fatmira Luli* (anëtare)
5. *Brunilda Kadi* (anëtare)
6. *Dritan Hallunaj* (anëtar)
7. *Ilir Toska* (anëtar)
8. *Alban Toro* (anëtar)
9. *Brikena Ukperaj* (anëtar)
10. *Erjon Muharremaj* (anëtar)
11. *Marçela Shehu* (anëtare)

Merrnin pjesë gjithashtu:

- 1. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
- 2. Elis Kuçi, Specialist pranë Drejtorisë së Marrëdhënieve me Publikun, me Jashtë dhe Botimet.*
- 3. Pjesë nga stafi administrativ i KLGJ-së (nëpërmjet platformës).*
- 4. Entela Dobi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë (nëpërmjet platformës).*
- 5. Përfaqësues të misioneve EURALIUS dhe USAID (nëpërmjet platformës).*

RENDI I DITËS:

8. Shqyrtimi i projektvendimit “Për rishpalljen e kërkesës për kandidatura nga radhët e gjyqtarëve për komandim në Ministrinë e Drejtësisë, kohëzgjatjen, kriteret dhe procedurën e komandimit”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Naureda Llagami: Kalojmë më pas në projekt-aktin tjetër i cili ka të bëjë me rishpalljen e kërkesës për kandidatura nga radhët e gjyqtarëve për komandim në Ministrinë e Drejtësisë, kohëzgjatjen, kriteret dhe procedurën e komandimit. Ky projekt-akt do të relatohet nga zoti Alban Toro.

Alban Toro: Faleminderit!

Atëherë, Këshilli i Lartë Gjyqësor, në çdo rast kur Ministria e Drejtësisë ka kërkuar komandimin e magistratëve për pozicione vakante të hapura nga ana e saj, ka reaguar në mënyrë të menjëhershme duke bërë shpalljen e tyre. Edhe në rastin konkret për dy pozicione, të Drejtorit të Drejtorisë së Hartimit të Legjislacionit, dhe Përgjegjësit të Sektorit të Hartimit të Akteve, në Drejtorinë e Hartimit të Legjislacionit, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Kodifikimit dhe Harmonizimit të Legjislacionit, KLGJ ka reaguar në bazë të kërkesave dhe kriterëve specifike të përcaktuara nga Ministria e Drejtësisë për këto dy pozicione, duke bërë shpalljen e kandidaturave për këto pozicione, mjafton të kujtojmë vendimet nr. 281, datë 10.12.2019 si dhe vendimin 100, datë 26.02.2020, por që fatkeqësisht me gjithë shpalljen e pozicioneve me kriteret që kërkohen nga Ministria e Drejtësisë, nuk ka pasur interesim nga ana e gjyqtarëve. Në këtë kontekst,

Ministria e Drejtësisë ka ripërsëritur me shkresën nr.493/2 prot., datë 01.07.2020, duke kërkuar ripërsëritjen e shpalljes dhe në këtë kuadër kemi përgatitur draftin e vendimit të cilin e kemi kompozuar me Kreun e parë ku bëhet përcaktimi i pozicioneve për të cilat kërkohen kërkesa për kandidatura. Më pas janë përcaktuar afatet në të cilat duhen paraqitur këto kërkesa, si dhe dokumentat që duhet të plotësojë kandidati në kuadër të shqyrtimit të kërkesës së paraqitur.

Në Kreun e dytë të projektvendimit, përcaktohet kohëzgjatja, kriteret dhe procedura e komandimit, si dhe në pikën e fundit të tij rregullohet situata ligjore kur asnjë prej kandidatëve nuk plotësojnë kushtet dhe kriteret e komandimit apo kur asnjë prej tyre nuk përzgjidhet dhe kërkohet të komandohet nga Ministria e Drejtësisë.

Gjithashtu është parashikuar edhe mundësia e rishpalljes nëse përsëri do të jemi në kushtet kur nga ana e gjyqtarëve do të ketë mungesë interesi për pozicionet e hapura dhe të kërkuara nga Ministria e Drejtësisë.

Përfundimisht kemi përgatitur projektvendimin, në dispozitivin e të cilit ju do të gjeni të sugjeruar, së pari, rishpalljen e kërkesës për kandidatura nga radhët e gjyqtarëve për komandim në Ministrinë e Drejtësisë për:

a) Pozicionin “Drejtor i Drejtorisë së Hartimit të Legjislacionit”, në Drejtorinë e Përgjithshme të Kodifikimit dhe Harmonizimit të Legjislacionit;

b) Pozicionin “Përgjegjës i Sektorit të Hartimit të Akteve”, në Drejtorinë e Hartimit të Legjislacionit, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Kodifikimit dhe Harmonizimit të Legjislacionit.

Afati i paraqitjes së kërkesave për komandim është dy javë nga dita e shpalljes së këtij vendimi në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Kandidati për secilin nga dy pozicionet, duhet të paraqesë këto dokumente:

a) Kërkesë me shkrim për shfaqjen e vullnetit për komandim ku të specifikohet pozicioni ku kërkon të komandohet;

b) Jetëshkrim, ku kandidati pasqyron, veç të tjerash, çdo të dhënë në lidhje me kriteret e komandimit, përveç edhe të dhënat mbi historikun e arsimimit dhe rezultatet e tij;

c) Diplomë për fitimin e titulli magjistrat, lëshuar nga Shkolla e Magjistraturës;

ç) Dokument që vërteton përvojën në hartimin e akteve;

- d) Certifikatë/Dëshmi për zotërim gjuhe të huaj;
- e) Rekomandime për aftësitë organizative dhe të komunikimit, si dhe për të punuarit në grup;
- ë) Certifikatë/Dëshmi për njohjen dhe përdorimin e programeve kompjuterike bazë;
- f) Çdo dokument tjetër që tregon plotësimin nga kandidati të kriterëve të komandimit.

Kohëzgjatja e komandimit, në secilin nga dy pozicionet e shpallura, është deri në 5 (pesë) vjet.

Kohëzgjatja e komandimit, në secilin nga dy pozicionet e shpallura, mund të përfundojë para afatit:

- a) me kërkesë të gjyqtarit, për shkaqe të justifikuara;
- b) kur vazhdimi i komandimit bie ndesh me interesat e lartë të gjykatës ku i komanduari ushtron funksionin e gjyqtarit.

Kushtet e komandimit, në secilin nga dy pozicionet e shpallura, janë:

- a) Komandimi nuk duhet të bjerë ndesh me interesat e lartë të gjykatës ku kandidati ushtron funksionin e gjyqtarit;
- b) Kandidati nuk duhet të jetë në një pozicion me mandat të kufizuar;
- c) Kandidati nuk duhet të jetë i komanduar;
- ç) Kandidati, që ka qenë i komanduar më parë, duhet të ketë shërbyer jo më pak se 5 (pesë) vjet si gjyqtar pas përfundimit të periudhës së mëparshme të komandimit;
- d) Kandidati nuk duhet të ketë masë disiplinore në fuqi.

Kriteret e komandimit për pozicionin “Drejtor i Drejtorisë së Hartimit të Legjislacionit”, në Drejtorinë e Përgjithshme të Kodifikimit dhe Harmonizimit të Legjislacionit, janë:

- a) kandidati duhet të ketë përfunduar Shkollën e Magjistraturës;
- b) kandidati duhet të ketë ushtruar profesionin e gjyqtarit për të paktën 5 vjet, duke u vlerësuar pozitivisht pasja përvojë në hartim aktesh, si dhe në pozicione drejtuese;
- c) kandidati duhet të zotërojë një gjuhë të huaj, preferohet anglisht;
- ç) kandidati duhet të mos ketë masë disiplinore në fuqi;

d) kandidati duhet të ketë aftësi shumë të mira organizative dhe komunikimi, si dhe për të punuar në grup;

dh) kandidati duhet të ketë njohuri bazë në përdorimin e kompjuterit.

Kriteret e komandimit për pozicionin “Përgjegjës i Sektorit të Hartimit të Akteve”, në Drejtorinë e Hartimit të Legjislacionit, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Kodifikimit dhe Harmonizimit të Legjislacionit, janë:

a) kandidati duhet të ketë përfunduar Shkollën e Magjistraturës;

b) kandidati duhet të ketë ushtruar profesionin e gjyqtarit për të paktën 3 (tre) vjet, duke u vlerësuar pozitivisht pasja përvojë në hartim aktesh, si dhe në pozicione drejtuese;

c) kandidati duhet të zotërojë një gjuhë të huaj, preferohet anglisht;

ç) kandidati duhet të mos ketë masë disiplinore në fuqi;

d) kandidati duhet të ketë aftësi shumë të mira organizative dhe komunikimi, si dhe për të punuar në grup;

dh) kandidati duhet të ketë njohuri bazë në përdorimin e kompjuterit.

Për vlerësimin e kushteve të kandidimit, Këshilli i Lartë Gjyqësor mbështetet në dokumentacionin e paraqitur nga kandidati, si dhe në dokumentacionin e dosjes personale të kandidatit të administruar pranë Këshillit.

Brenda dy javëve pas përfundimit të afatit të aplikimit, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës përgatit një projekt-opinion për çdo kandidat dhe vlerëson nëse komandimi nuk është në përputhje me interesat e lartë të gjykatës ku kandidati ushtron funksionin. Projekt-opinionin për çdo kandidat shqyrtohet nga Këshilli i Lartë Gjyqësor jo më vonë se një javë pas njoftimit të Kryetarit të Këshillit për përgatitjen e tyre. Opinione të miratuara nga Këshilli publikohen në faqen zyrtare të tij. Këshilli mund të vendosë përjashtimin nga komandimi të kandidatit kur komandimi nuk është në përputhje me interesat e lartë të gjykatës ku ai ushtron funksionin ose kur verifikohet që kandidati nuk plotëson ndonjë prej kushteve të tjera të komandimit.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, i përcjellë menjëherë Ministrisë së Drejtësisë aplikimet e kandidatëve të cilët plotësojnë kushtet për komandimin në pozicionin “Drejtor i Drejtorisë së Hartimit të Akteve”, në Drejtorinë e Përgjithshme të Kodifikimit dhe Harmonizimit të Legjislacionit dhe në pozicionin “Përgjegjës i Sektorit të Hartimit të

Akteve”, në Drejtorinë e Hartimit të Legjislacionit, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Kodifikimit dhe Harmonizimit të Legjislacionit.

Brenda dy javëve nga marrja e kërkesës, Këshilli i Lartë Gjyqësor, vendos për komandimin, në pozicionet respektive, të secilit kandidat të përzgjedhur nga Ministria e Drejtësisë.

Nëse asnjë prej kandidatëve nuk plotëson kushtet dhe/ose kriteret e komandimit apo kur asnjë prej tyre nuk përzgjidhet dhe kërkohet të komandohet nga Ministria e Drejtësisë, pas njoftimit dhe mbi kërkesën e kësaj të fundit, Këshilli i Lartë Gjyqësor mund të rishpallë kërkesën për kandidatura nga radhët e gjyqtarëve për plotësimin e pozicionit “Drejtor i Drejtorisë së Hartimit të Akteve”, në Drejtorinë e Përgjithshme të Kodifikimit dhe Harmonizimit të Legjislacionit dhe të pozicionit “Përgjegjës i Sektorit të Hartimit të Akteve”, në Drejtorinë e Hartimit të Legjislacionit, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Kodifikimit dhe Harmonizimit të Legjislacionit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit, zoti Toro!

Nëse nuk kemi diskutime mbi projekt-aktin, e hedhim në votim?

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ilir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi rishpalljen e kërkesës për kandidatura nga radhët e gjyqtarëve për komandim në Ministrinë e Drejtësisë, kohëzgjatjen, kriteret e dhe

procedurat e komandimit, sipas propozimit të bërë nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

* * *

(Pika 8 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2020

PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 09.07.2020)

Pika 9 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për rishpërndarjen e fondeve për masat higjienizuese në gjykata”, i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik dhe Administrimit të Buxhetit.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:00 dhe mbaroi në orën 13:30.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Maksim Qoku*** (zëvendëskryetar)
3. ***Medi Bici*** (anëtar)
4. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
5. ***Brunilda Kadi*** (anëtare)
6. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
7. ***Illir Toska*** (anëtar)
8. ***Alban Toro*** (anëtar)
9. ***Brikena Ukperaj*** (anëtar)
10. ***Erjon Muharremaj*** (anëtar)
11. ***Marçela Shehu*** (anëtare)

Merrnin pjesë gjithashtu:

- 1. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
- 2. Elis Kuçi, Specialist pranë Drejtorisë së Marrëdhënieve me Publikun, me Jashtë dhe Botimet.*
- 3. Pjesë nga stafi administrativ i KLGJ-së (nëpërmjet platformës).*
- 4. Entela Dobi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë (nëpërmjet platformës).*
- 5. Përfaqësues të misioneve EURALIUS dhe USAID (nëpërmjet platformës).*

RENDI I DITËS:

9. Shqyrtimi i projektvendimit “Për rishpërndarjen e fondeve për masat higjienizuese në gjykata”, i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik dhe Administrimit të Buxhetit.

Naureda Llagami: Kalojmë në projekt-aktin e radhës i cili ka të bëjë me një projektvendim për rishpërndarjen e fondeve për masat higjienizuese në gjykata. Për më shumë detaje do ftoja Drejtoreshën Luljeta Laze.

Luljeta Laze: Bazuar në Vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor, nr. 146, datë 27.04.2020 “Për përcaktimin e masave për kufizimin e përhapjes së COVID-19 gjatë ushtrimit të veprimtarisë gjyqësore dhe administrative në Gjykata”, Departamenti i Programimit dhe Administrimit të Buxhetit, vlerëson se gjykatat kanë nevojë për buxhet shtesë për realizimin e këtyre masave. Sikurse jemi në dijeni, me Aktin Normativ nr. 15/2020 është rishikuar në ulje buxheti i gjykatave në shpenzime operative, zë buxhetor, prej të cilit realizohet një pjesë e mirë e masave të përcaktuara në Vendimin nr. 146, datë 27.04.2020. Në këtë kuptim, në një analizë të detajuar të buxhetit të gjykatave vlerësojmë se ka mundësi për të rialokuar fonde shtesë për gjykatat në shpenzimet operative, nëpërmjet fondeve të papërdorura në shpenzimet e personelit.

Pasi është rialokuar fondi shtesë për efektet e Vendimin nr. 115, datë 05.03.2020, të KLGJ-së “Për detajimin e numrit shtesë prej 100 punonjësish të administratës gjyqësore, sipas ligjit të buxhetit nr.88/2019”, dhe gjithashtu është përcaktuar nevoja e buxhetit që do të duhet pas caktimit në detyrë të magjistratëve që mbarojnë Shkollën e

Magjistraturës në 2020, është vlerësuar se mbeten përsëri fonde të papërdorura, në shpenzimet e personelit të programit “Buxheti gjyqësor”, të cilat mendojmë të përdoren (një pjesë e tyre) për nevojat e gjykatave dhe kryesisht në këtë moment për efektet e Vendimit të KLGJ-së nr. 146, datë 27.04.2020.

Rialokimi i fondeve do të shërbejë për mbulimin e nevojave buxhetore për:

Vendosjen e aparateve të fiksuara në mur për xhel dezinfektues, në ambientin e brendshëm ku ndodhen zyrat e gjyqtarëve dhe të stafit administrative, në ambientet e sallave të gjyqit si dhe ato të shërbimit të publikut.

Maska dhe Doreza. Janë bërë përllogaritje për nevojën për maska dhe doreza për një periudhë 1-mujore.

Shërbim i dezinfektimeve për ambientet. Disa prej gjykatave kanë kryer dezinfektim të ambienteve, por është e nevojshme dezinfektimi i herëpashershëm. Kjo mbetet në vlerësim të gjykatës nisur nga intensiteti i punës apo situatave konkrete në të cilën ndodhen.

Për sa më sipër, për realizimin e këtyre masave sugjerojmë:

Transferimin e fondeve në shumën prej 8,500 mijë lekë, brenda programit “Buxheti Gjyqësor”, duke zvogëluar artikullin shpenzime personeli në shumën prej 8 milion e 500 mijë lekë, si dhe duke shtuar artikullin shpenzime operative në këtë shumë.

Shpërndarjen e shumës prej 8,500 mijë lekë, në gjykatat e të gjitha niveleve sipas pasqyrës bashkëlidhur.

Pasqyrën bashkëlidhur e keni. T’jua lexoj?

Ky është propozimi që kemi për rishpërndarjen e fondeve.

Naureda Llagami: Faleminderit, Luli!

Ftoj kolegët nëse kanë ndonjë pyetje, paqartësi apo sqarim.

Nëse jo, kalojmë në votim?

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Dakord.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ilir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi: 1. Transferimin e fondeve në shumën prej 8,500 mijë lekë, brenda programit “Buxheti Gjyqësor”, duke zvogëluar artikullin shpenzime personeli në shumën prej 8,500 mijë lekë, dhe duke shtuar artikullin shpenzime operative në shumën prej 8,500 mijë lekë. 2. Shpërndarjen e shumës prej 8,500 mijë lekë, në gjykatat e të gjitha niveleve sipas pasqyrës bashkëlidhur. 3. Fondet e parashikuara më sipër do të përdoren për vendosjen e aparateve të fiksuara në mur për xhel dezinfektues, për maska dhe doreza, si dhe për dezinfektimin e ambienteve të gjykatave. 4. Me zbatimin e këtij vendimi, ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm dhe Departamenti i Programimit dhe Administrimit të Buxhetit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 9 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2020

PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 09.07.2020)

Pika 10 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Mbi shpërndarjen e fondeve në investime”, i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik dhe Administrimit të Buxhetit.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:00 dhe mbaroi në orën 13:30.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|-----------------------------|---------------------------------|
| 1. Naureda Llagami | <i>(kryetare)</i> |
| 2. Maksim Qoku | <i>(zëvendëskryetar)</i> |
| 3. Medi Bici | <i>(anëtar)</i> |
| 4. Fatmira Luli | <i>(anëtare)</i> |
| 5. Brunilda Kadi | <i>(anëtare)</i> |
| 6. Dritan Hallunaj | <i>(anëtar)</i> |
| 7. Ilir Toska | <i>(anëtar)</i> |
| 8. Alban Toro | <i>(anëtar)</i> |
| 9. Brikena Ukperaj | <i>(anëtar)</i> |
| 10. Erjon Muharremaj | <i>(anëtar)</i> |
| 11. Marçela Shehu | <i>(anëtare)</i> |

Merrnin pjesë gjithashtu:

1. *Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
2. *Elis Kuçi, Specialist pranë Drejtorisë së Marrëdhënieve me Publikun, me Jashtë dhe Botimet.*
3. *Pjesë nga stafi administrativ i KLGJ-së (nëpërmjet platformës).*
4. *Entela Dobi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë (nëpërmjet platformës).*
5. *Përfaqësues të misioneve EURALIUS dhe USAID (nëpërmjet platformës).*

RENDI I DITËS:

10. Shqyrtimi i projektvendimit “Mbi shpërndarjen e fondeve në investime”, i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik dhe Administrimit të Buxhetit.

Naureda Llagami: Kalojmë më pas në projekt-aktin tjetër i cili ka të bëjë me shpërndarjen e fondeve të investimeve. Edhe për këtë projekt-akt ftoj prapë zonjën Laze të relatojë nevojën e këtij projekt-akti.

Luljeta Laze: Me Vendimin nr.71, datë 20.02.2020 “Për detajimin e fondeve buxhetore, në shpenzime kapitale në sistemin gjyqësor, për vitin 2020”, të KLGJ-së, është detajuar dhe shpërndarë, fondi i akorduar për investime në programin “Buxheti gjyqësor” për të gjitha gjykatat e vendit, në të cilën është detajuar shuma prej 48,720 mijë lekë, për rikonstruksion dëm nga tërmeti, por që në fakt nuk është shpërndarë për gjykatat.

Për sa i takon nevojës për fonde buxhetore për riparimin e dëmeve të shkaktuara nga tërmeti i 26 nëntorit 2019, u vendos që t’i alokoheshin fonde vetëm Gjykatës së Apelit Durrës, për arsye se nga ana e kësaj gjykate ishin përfunduar të gjithë proceset e ekspertizës për dëmet e tërmetit, kishte përfunduar gjithashtu procesi i vlerësimit të dëmeve sipas procedurës ligjore dhe nga ana tjetër ishte e programuar kjo gjykatë për të alokuar fonde në investime, për shkak se kishte kërkuar fonde të tjera për përmirësimin e infrastrukturës ndërtimore dhe në këtë kuptim, kur u detajuan fondet që ishin caktuar për përmirësimin e infrastrukturës, u detajuan edhe fondet për riparimin e

dëmeve nga tërmeti për shkak se ajo i kishte mbaruar, sikurse thamë, të gjitha procedurat ligjore.

Qëllimi i nevojës për rialokimin e fondeve për investime në programin “Buxheti i Gjykatave” në këtë moment, ka ardhur si rezultat i administrimit të informacioneve që disponon departamenti ynë për gjendjen e infrastrukturës ndërtimore në gjykatat e prekura nga tërmeti i nëntorit 2019.

Në zbatim të Urdhrit nr. 4, datë 06.12.2019, “Për evidentimin dhe vlerësimin e dëmeve në godinat e gjykatave të prekura nga tërmeti”, u ngrit grupi i punës i drejtuar nga Zv/Kryetari Z. Maksim Qoku.

Konkretisht janë inspektuar 13 gjykata, të cilat janë: Gjykata e Apelit Tiranë, Gjykata e Apelit të Krimeve të Rënda, Gjykata e Apelit Administrativ Tiranë, Gjykata e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, Gjykata e Apelit Durrës, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kavajë, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Krujë, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kurbin, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë, Gjykata e Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, Gjykata e Administrative e Shkallës së Parë Durrës.

Në përfundim të ekspertizave të kryera edhe nga grupet e ekspertimit të pushtetit lokal dhe atij të Institutit të Ndërtimit, rezultoi kjo gjendje e nivelit të dëmeve të gjykatave:

Nga 13 gjykata të konsideruara për shkak të vendndodhjes së godinave të tyre pranë epiqendrës së tërmetit, në 4 prej tyre (Gjykata e Apelit Tiranë, Gjykata e Apelit Administrativ Tiranë, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kavajë dhe Gjykata Administrative e Shkallës Parë Durrës), nuk janë evidentuar dëme. Në 5 (pesë) gjykata janë evidentuar dëme të lehta, por që kanë nevojë për riparime dhe në 4 (katër) prej tyre janë evidentuar dëmtime të nivelit mbi mesatar dhe të konstruksionit mbajtës. Për shkak të këtyre dëmtimeve, me Vendim të KLGJ-së, Gjykata e Apelit Durrës dhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë, janë vendosur në ambiente të tjera për kryerjen e veprimtarisë gjyqësore, përkatësisht në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kavajë dhe në ambientet e Prokurorisë së Rrethit Lezhë.

Në procesin e inspektimit dhe të vlerësimit të dëmeve të shkaktuara nga tërmeti, u përfshi nëpërmjet grupit të saj të punës edhe Ministria e Drejtësisë.

Në aktin normativ nr. 9, datë 16.12.2019 “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore” përcaktohet se “autoritet përgjegjës për përballimin e nevojave të fatkeqësisë është ... Komisioni Shtetëror i Rindërtimit....”.

Në këtë moment, prandaj thashë që kur ne kemi detajuar fondin., sikurse thashë me vendimin e KLGJ-së datë 20.02. kishim përcaktuar një fond por ndenjëm në moment pritës meqenëse nga ky akt normativ ishte përcaktuar që këto të kryheshin me fondet e Komisionit Shtetëror të Rindërtimit dhe nga ana e saj Ministria e Drejtësisë me shkresat përkatëse, më 14.01.2020, ka njoftuar gjykatat shprehimisht me të njëjtin tekst “...do të kryejë një analizë të thelluar të dëmeve dhe pas përcaktimit të saktë të vlerës do të ndërhyhet për eliminimin e këtyre pasojave”.

Pas shkresës së Ministrisë së Drejtësisë, nr. 8166/2, datë 24.12.2019, “Dërgim informacioni mbi evidentimin e dëmeve nga lëkundjet e tërmetit të datës 26 nëntor 2019”, i cili përmbante një informacion fillestar mbi gjendjen e këtyre dëmeve, nuk dispononin asnjë informacion tjetër shkresor mbi ecurinë e këtij procesi.

Pas periudhës së pandemisë, që u kthyer këtu, struktura përkatëse në departamentin tonë, sigurisht duke reflektuar edhe shqetësimet që kanë gjykatat të cilat kanë këto dëme nga tërmeti, bën një vlerësim të situatës. Së pari, jemi drejtuar me një shkresë Ministrisë së Drejtësisë për të marrë një informacion shtesë mbi ecurinë e procesit, pasi sikurse ju thashë, që nga janari nuk kishim asnjë informacion dhe edhe sot e kësaj dite, një informacion shtesë nuk na ka ardhur. Nga ana tjetër vlerësuam edhe faktin që fondi është në dispozicion, gjykatat duhet t’i kryejnë këto riparime, për më tepër pastaj, Gjykata e Rrethit Lezhë e cila është vërtetë në vështirësi për mënyrën se si po e kryen aktivitetin e saj të përditshëm dhe duke vlerësuar edhe faktet që përpara është gushti, që është muaji i pushimeve, është më i përshtatshmi për të kryer këto riparime të dëmeve nga tërmeti, u aktivizua sikurse thashë struktura dhe edhe një herë iu kërkoi gjykatave që të bënin vlerësime të sakta nëpërmjet procedurave ligjore që janë për përcaktimin e këtyre dëmeve. Në një kohë të shpejtë erdhën të gjitha vlerësimet nga studiot përkatëse, sikurse është e përcaktuar në aktet ligjore, se si bëhet vlerësimi për një punim të ndërtimit dhe në përfundim të kësaj kemi vlerësimet për të gjitha gjykatat që kanë nevojë për riparimin e këtyre dëmeve.

Propozimi ynë është që meqenëse ne fondet i kemi në dispozicion, nuk kemi më asnjë informacion të mëtejshëm nga Ministria e Drejtësisë, përfaqësuar qeverinë në këtë rast, dhe meqenëse është i domosdoshëm riparimi i këtyre dëmeve dhe aq më tepër për Gjykatën e Lezhës dhe rikthimi i saj në gjykatë për të kryer proceset në kohën e duhur, propozojmë një shpërndarje, bile një pjesë shumë të vogël të fondeve për të kryer këto riparime.

Gjykata e Apelit për KKO ka kërkuar 250 mijë lekë; Gjykata e Rrethit Durrës 385 mijë lekë; Gjykata e Rrethit Gjyqësor Krujë 960 mijë lekë; Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë (të 2 dhomat) 3,475 mijë lekë; Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë 1,000 mijë lekë; Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kurbin 2,365 mijë lekë dhe në total, për riparimin e të gjitha dëmeve janë 8 milion 435 mijë lekë, të cilat mendojmë që t'i marrim pikërisht nga fondi që kishim lënë të pashpërndara për këtë destinacion. Kaq ishte propozimi.

Naureda Llagami: Faleminderit, zonja Laze!

Atëherë, ftoj kolegët nëse kanë propozime, diskutime, pyetje mbi shpërndarjen.

Nëse nuk kemi, kalojmë në votim?

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Dakord.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ilir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi: 1. Shpërndarjen e fondeve për riparimin e dëmeve të shkaktuara nga tërmeti, nga fondet për investime, në programin buxhetor “Buxheti i Gjykatave”, sipas pasqyrës bashkëlidhur këtij vendimin. 2. Me zbatimin e këtij Vendimi,

ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm dhe Departamenti i Programimit dhe Administrimit të Buxhetit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 10 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2020

PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 09.07.2020)

Pika 11 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për rishikimin e buxhetit në sistemin gjyqësor, për vitin 2020 sipas aktit normative nr.28, datë 02.07.2020”, i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik dhe Administrimit të Buxhetit.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:00 dhe mbaroi në orën 13:30.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. *Naureda Llagami* (kryetare)
2. *Maksim Qoku* (zëvendëskryetar)
3. *Medi Bici* (anëtar)
4. *Fatmira Luli* (anëtare)
5. *Brunilda Kadi* (anëtare)
6. *Dritan Hallunaj* (anëtar)
7. *Ilir Toska* (anëtar)
8. *Alban Toro* (anëtar)
9. *Brikena Ukperaj* (anëtar)
10. *Erjon Muharremaj* (anëtar)
11. *Marçela Shehu* (anëtare)

Merrnin pjesë gjithashtu:

- 1. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
- 2. Elis Kuçi, Specialist pranë Drejtorisë së Marrëdhënieve me Publikun, me Jashtë dhe Botimet.*
- 3. Pjesë nga stafi administrativ i KLGJ-së (nëpërmjet platformës).*
- 4. Entela Dobi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë (nëpërmjet platformës).*
- 5. Përfaqësues të misioneve EURALIUS dhe USAID (nëpërmjet platformës).*

RENDI I DITËS:

11. Shqyrtimi i projektvendimit “Për rishikimin e buxhetit në sistemin gjyqësor, për vitin 2020 sipas aktit normative nr. 28, datë 02.07.2020”, i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik dhe Administrimit të Buxhetit.

Naureda Llagami: Kalojmë në projekt-aktin e radhës i cili ka të bëjë me rishikimin e buxhetit në sistemin gjyqësor, për vitin 2020 sipas aktit normative nr. 28, datë 02.07.2020. Për më shumë detaje, fjalën e ka sërish zonja Laze.

Relatimi i kësaj çështjeje bëhet nga zoti Haxhiu.

Xhevdet Haxhiu: Përshëndetje të gjithëve!

Buxheti i sistemit gjyqësor me aktin normativ nr. 28, datë 02.07.2020 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 88/2019 “Për buxhetin e vitit 2020, i ndryshuar””, ka pakësuar në buxhetin tonë për vitin 2020 fondin prej 153,000,000 lekë.

Pakësimi i buxhetit sipas këtij akti, konsiston në pakësimin e fondeve buxhetore: në programin buxheti i KLGJ-së, në vlerën 13,000,000 lekë, në shpenzime korrente dhe në programin e gjykatave, në shpenzime korrente, në shumën 140,000,000 lekë,

Lidhur me këtë pakësim, Ministria e Financave i ka kërkuar KLGJ-së detajimi e zërave të shpenzimeve dhe të njësive shpenzuese të cilat do preken nga ky shkurtrim.

Ndodhur para këtij fakti, struktura përgjegjëse për administrimin e buxhetit, për të realizuar detajimin e këtij pakësimi, administroi, analizoi dhe konsultoi brenda strukturës, disa tregues të rëndësishëm ekonomiko-financiar si më poshtë:

Numri i punonjësve (sipas strukturës organizative dhe organikës në fakt), në KLGJ dhe për çdo gjykatë; Buxheti vjetor i miratuar, në shpenzime korrente dhe ndryshimi i buxhetit vjetor nga akti normativ nr. 15, datë 15.04.2020; Realizimi i fondeve buxhetore për shpenzime personeli, për 5-mujorin e parë 2020, në KLGJ dhe për çdo gjykatë; Realizimi i pritshëm i këtyre shpenzimeve, në shpenzime korrente.

Gjithashtu ne kemi mbajtur parasysh nevojat buxhetore për fond page për parashikimet si më poshtë: emërimin e shpejt të mundshëm të 15 magjistratëve të rinj, ku kemi llogaritur një fond page përafërsisht për 5 muaj; emërimet e reja që priten në Gjykatën e Lartë, duke supozuar afërsisht 8 magjistratëve për 4 muajt e ardhshëm.

Duke vlerësuar të gjithë konkluzionet e këtyre treguesve, për sa më sipër rezulton se pakësimi i 13 milion lekëve në programin “Buxheti i KLGJ-së”, do të konsistojë në zërin “shpenzime personeli dhe përkatësisht në zërin “shpenzime paga”. Në programin “Buxheti i Gjykatave”, në shpenzime korrente të shumës 140,000,000 lekë, të ndara në “shpenzime personeli” paga në 92,000,000 lekë dhe “shpenzime paga personeli” në Gjykatën e Lartë 48,000,000 lekë.

Për sa më sipër sugjerojmë: Miratimin e rishikimit të buxhetit për vitin 2020, në programin e KLGJ-së, 01110, duke pakësuar fondet buxhetore në shpenzime personeli, “shpenzime paga”, në shumën prej 13,000,000 lekë. Miratimin e rishikimit të buxhetit për vitin 2020, në programin e gjykatave, “Buxheti i Gjykatave”, duke pakësuar fondet buxhetore në shpenzime personeli, në shumën 140,000,000 lekë, nga të cilat 80,000,000 lekë në “shpenzime paga”, 12,000,000 në “shpenzime sigurime shoqërore” dhe 48,000,000 lekë në “shpenzime paga” në Gjykatën e Lartë. Faleminderit për vëmendjen.

Naureda Llagami: Faleminderit!

Ftoj kolegët tuar për diskutim lidhur me projekt-aktin.

Tuaj përparim, atyherë kalon votimi?

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Dakord.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ilir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi: 1. Miratimin e rishikimit të buxhetit për vitin 2020, në programin e KLGJ-së, 01110 “Planifikim, Menaxhim, Administrim”, duke pakësuar fondet buxhetore në shpenzime personeli (paga- 600), në shumën prej 13,000,000 lekë.

2. Miratimin e rishikimit të buxhetit për vitin 2020, në programin e gjykatave, 03310 “Buxheti i Gjykatave”, duke pakësuar fondet buxhetore në shpenzime personeli në shumën prej 140,000,000 lekë, i ndarë në (paga-600) 128,000,000 lekë dhe (sigurime shoqërore – 601) 12,000,000 lekë. Fondi prej 128,000,000 lekë pakësohet: 48,000,000 lekë në shpenzime për paga (600) të Gjykatës së Lartë dhe 80,000,000 lekë në shpenzime për paga të mbajtura të pashpërndara.

3. Me zbatimin e këtij Vendimi, ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm dhe Departamenti i Programimit dhe Administrimit të Buxhetit,

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 11 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2020

PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 09.07.2020)

Pika 12 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për ndërprerjen e marrëdhënieve në shërbimin civil gjyqësor të kancelares të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë znj. {...} për shkak të dorëheqjes”, i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik dhe Administrimit të Buxhetit.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:00 dhe mbaroi në orën 13:30.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. *Naureda Llagami* (kryetare)
2. *Maksim Qoku* (zëvendëskryetar)
3. *Medi Bici* (anëtar)
4. *Fatmira Luli* (anëtare)
5. *Brunilda Kadi* (anëtare)
6. *Dritan Hallunaj* (anëtar)
7. *Ilir Toska* (anëtar)
8. *Alban Toro* (anëtar)
9. *Brikena Ukperaj* (anëtar)
10. *Erjon Muharremaj* (anëtar)
11. *Marçela Shehu* (anëtare)

Merrnin pjesë gjithashtu:

1. *Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
2. *Elis Kuçi, Specialist pranë Drejtorisë së Marrëdhënieve me Publikun, me Jashtë dhe Botimet.*
3. *Pjesë nga stafi administrativ i KLGJ-së (nëpërmjet platformës).*
4. *Entela Dobi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë (nëpërmjet platformës).*
5. *Përfaqësues të misioneve EURALIUS dhe USAID (nëpërmjet platformës).*

RENDI I DITËS:

12. Shqyrtimi i projektvendimit “Për ndërprerjen e marrëdhënieve në shërbimin civil gjyqësor të kancelares të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë znj. {...} për shkak të dorëheqjes”, i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik dhe Administrimit të Buxhetit.

Naureda Llagami: Kalojmë në projekt-aktin e radhës i cili ka të bëjë me ndërprerjen e marrëdhënieve në shërbimin civil gjyqësor të kancelares së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë znj. {...}, për shkak të dorëheqjes. Për më shumë detaje, fjalën ia jap zotit Bici për relatimin e këtij projekt-akti.

Medi Bici: Faleminderit, zonja Kryetare!

Pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, është depozituar në rrugë elektronike dhe, kërkesa e kancelares së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë znj. {...}, e cila informon lidhur me kërkesën e saj për dorëheqje nga detyra e kancelares.

Konkretisht, me shkresën nr.855 prot., datë 06.07.2020, kancelarja pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, ka paraqitur aktin e dorëheqjes së saj për miratim pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor. Ajo është emëruar kancelare pranë kësaj gjykate me urdhrin nr. 338, datë 23.06.2014, nga Ministri i Drejtësisë dhe ka shprehur vullnetin e saj për të kërkuar dorëheqjen si rrjedhojë e shpalljes fituese për pozicionin e punës Këshilltar, në Njësinë Mbështetëse të Komisioneve të Përhershme, pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenin 90, pika c) të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, ka në kompetencë të tij ndër të tjera emërimin e kancelarëve të gjykatave. Edhe në nenin 59, pika 1, të Ligjit nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë” përcaktohet se: Organi kompetent për emërimin e kancelarit, këshilltarit dhe ndihmësit ligjor është Këshilli i Lartë Gjyqësor ...”. Ndërkohë lidhur me vijimin e marrëdhënieve të punës dhe ndërprerjen e tyre, në nenin 80 të ligjit nr. 98/2016, theksohet se:

“3.Organi kompetent për ndërprerjen e marrëdhënies në shërbimin civil gjyqësor për kancelarin, këshilltarin dhe ndihmësin ligjor është Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe për nëpunësit e tjerë civilë gjyqësorë është Këshilli i Gjykatës ku ai ushtron detyrën.”

Gjithashtu në këtë dispozitë theksohet se ndërprerja e marrëdhënieve në shërbimin civil gjyqësor i nënshtrohet rregullave të parashikuara në ligjin “Për nëpunësin civil”, përveç rasteve kur parashikohet ndryshe në këtë ligj.

Pra, sa më sipër organi kompetent për emërimin e kancelarëve pranë gjykatave është Këshilli i Lartë Gjyqësor, po kështu edhe në rastin e ndërprerjes së marrëdhënieve në shërbimin civil gjyqësor, po ky Këshill është organi kompetent.

Në nenin 64, të Ligjit nr. 152/2013 “Për statusin e nëpunësit civil” parashikohet se nëpunësi mund të njoftojë përfundimin e marrëdhënies në shërbimin civil nëpërmjet paraqitjes së dorëheqjes me shkrim të njësia e burimeve njerëzore të institucionit, ku ushtron detyrën, ose DAP-it, në rastin e nëpunësit të TND-së. Ndërkohë që ky ligj parashikon që dorëheqja “... i prodhon efektet 30 ditë nga data e paraqitjes së saj”, ashtu si dhe “Në raste të justifikuara, me kërkesë të motivuar të nëpunësit dhe me miratimin e njësisë së përcaktuar sipas pikës 1 të këtij neni, dorëheqja i prodhon efektet përpara afatit 30-ditor nga njoftimi.”

Sa më sipër, Komisioni i Planifikimit Strategjik dhe Administrimit të Buxhetit, në kushtet e paraqitjes së dorëheqjes së motivuar të kancelares së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë për shkak të fitimit të konkursit për të qenë pjesë e institucionit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, i propozon Këshillit të Lartë Gjyqësor:

1. Ndërprerjen e marrëdhënieve në shërbimin civil gjyqësor të kancelares së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, znj. {...}, për shkak të dorëheqjes.
2. Njoftimin e këtij vendimi znj. {...} si dhe Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit, zoti Bici!

Kemi ndonjë diskutim nga kolegët?

Nëse jo, kalojmë në votimin e projekt-aktit?

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Dakord.

Dritan Hallunaj: Pro.

Illir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi: 1. Ndërprerjen e marrëdhënieve në shërbimin civil gjyqësor të kancelares së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë znj. {...}, për shkak të dorëheqjes. 2. Njoftimin e këtij vendimi znj. {...} si dhe Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 12 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2020

PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 09.07.2020)

Pika 13 shtesë e rendit të ditës me objekt: Caktimi i gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.¹

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:00 dhe mbaroi në orën 13:30.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Maksim Qoku*** (zëvendëskryetar)
3. ***Medi Bici*** (anëtar)
4. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
5. ***Brunilda Kadi*** (anëtare)
6. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
7. ***Illir Toska*** (anëtar)
8. ***Alban Toro*** (anëtar)
9. ***Brikena Ukperaj*** (anëtar)
10. ***Erjon Muharremaj*** (anëtar)

¹ Procesverballi i kësaj çështjeje të rendit të ditës është përmbledhje.

Merrnin pjesë gjithashtu:

- 1. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
- 2. Elis Kuçi, Specialist pranë Drejtorisë së Marrëdhënieve me Publikun, me Jashtë dhe Botimet.*
- 3. Valbona Bako, Specialiste pranë Sektorit të Përgatitjes së Dokumentacionit dhe Përfaqësimit në Gjykatë.*
- 4. Pjesë nga stafi administrativ i KLGJ-së (nëpërmjet platformës).*

RENDI I DITËS:

13 shtesë. Caktimi i gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Kalohet në çështjen e fundit e cila është shtesë në rendin e ditës. Fjala i jepet zotit Toska i cili bën një relativitet të shkurtër të dy kërkesave që kanë ardhur të karakterit tepër urgjent, nevoja për Gjykatën e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar dhe një tjetër në Gjykatën Administrative të Apelit.

Fillimisht vijohet me relativitetin e relacionit të parë **“Për caktim gjyqtari në Gjykatën e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar”**.

Ndër të tjera, në relacion thuhet që, Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar ka paraqitur nevojë për 4 çështje gjyqësore penale të karakterit tepër urgjent.

Propozimet e Komisionit janë:

Gjykatat nga duhet të përzgjidhen, me short, gjyqtarët që do të caktohen për gjykimin e 4 çështjeve gjyqësore, të jenë gjykatat e shkallës së parë me juridiksion të përgjithshëm dhe numri i gjyqtarëve të jetë 6. Gjyqtarët të përzgjidhen, me short, ndërmjet atyre të cilët kanë të paktën shtatë vjet përvojë në ushtrimin e profesionit, nga të

cilat të paktën pesë vjet si gjyqtar për çështjet penale, si dhe kanë kaluar me sukses procesin e rivlerësimit kalimtar sipas Ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Komisioni i Zhvillimit të Karrierës propozon gjithashtu:

Për çështjet nr.1, nr.2 dhe nr.3, për të cilat kërkohet caktimi i 1 dhe 2 gjyqtarëve, të caktohen 5 gjyqtarë, të cilët të përzgjidhen, me short, ndërmjet gjyqtarëve të gjykatave të shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm që plotësojnë kriteret si më lart. Në këtë rast, një gjyqtar nuk mund të caktohet në më shumë se 1 çështje.

Për çështjen nr.4, për të cilën kërkohen 3 gjyqtarë, si i përzgjedhur nga shorti dhe njëkohësisht relator i çështjes të konsiderohet gjyqtari që nuk është caktuar sipas pikës 1. Dy gjyqtarët e tjerë të përzgjidhen me short ndërmjet gjyqtarëve të caktuar sipas pikës 1.

Në relacion janë të evidentuar edhe gjyqtarët të cilët plotësojnë kriteret: 1. Alma Kolgjoka - Gjykata e Rrethit Gjyqësor Krujë; 2. Emona Muçi - Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pogradec; 3. Esmeralda Xhili (Çeka) - Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lushnjë; 4. Manjola Xhaxho - Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë; 5. Ornela Naqellari - Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë; 6. Rexhep Bekteshi - Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës.

Anëtarët e Këshillit janë dakord me propozimet e Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.

Nga shorti elektronik përzgjidhen (referuar tabelës në relacion):

Për çështjen nr. 1, penale, gjyqtarja Emona Muçi.

Për çështjen nr. 2, penale, gjyqtarët Alma Kolgjoka dhe Rexhep Bekteshi.

Për çështjen nr. 3, penale, gjyqtarët Ornela Naqellari dhe Manjola Xhaxho.

Për çështjen nr. 4, penale, gjyqtarët Esmeralda Xhili (relatore) (sipas propozimit të Komisionit e cila nuk ra në tre çështjet e para), Alma Kolgjoka dhe Ornela Naqellari (anëtarë).

Vijohet me relatimin e relacionit të dytë “**Për caktim gjyqtari në Gjykatën Administrative të Apelit**”.

Ndër të tjera, në relacion thuhet që, Gjykata Administrative e Apelit ka paraqitur nevojë për 2 çështje gjyqësore administrative me objekt “kërkesë për përjashtim gjyqtari”.

Propozimet e Komisionit janë:

Gjykata nga duhet të përzgjidhet, me short, gjyqtari që do të caktohet për gjykimin e 2 çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë Gjykata e Apelit Tiranë dhe numri i gjyqtarëve të jetë 1 dhe të zgjidhet nga gjyqtarët e Seksionit Civil të kësaj gjykate.

Sa i përket përjashtimeve nga shorti, propozohet që të përjashtohet nga shorti kryetari në detyrë (zëvendëskryetari) i Gjykatës së Apelit Tiranë, konkretisht: z. Ridvan Hado. Gjithashtu të përjashtohet nga shorti gjyqtari i Gjykatës së Apelit Tiranë që është caktuar më herët për gjykimin e një prej çështjeve që paraqet nevojë, konkretisht: z. Asim Vokshi. Në shortimin e çështjeve të përjashtohen nga shorti gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Tiranë që janë me leje afatgjatë nga ish-KLD-ja dhe konkretisht: z. Gjin Gjoni dhe znj. Evjeni Sinoimeri.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime ndaj propozimeve të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.

Nga shorti elektronik përzgjidhen (referuar tabelës në relacion):

Për çështjen nr. 1 dhe nr. 2, administrative, gjyqtarja Flutura Skënderi.

Mbledhja deklarohet e mbyllur.

* * *

(Pika 13 shtesë e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor